

**VENDIME
TË PËRZGJEDHURA**

**TË GJYKATËS EVROPIANE
TË TË DREJTAVE TË NJERIUT
(GJEDNJ)**

**NË LIDHJE ME GJYKATËN
E LARTË TË SHQIPËRISË**



**GJYKATA E LARTË
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDIME TË PËRZGJEDHURA
TË GJYKATËS EVROPIANE
TË TË DREJTAVE TË NJERIUT
(GJEDNJ)
NË LIDHJE ME GJYKATËN
E LARTË TË SHQIPËRISË



© Të drejtat e autorit në lidhje me përmbajtjen e këtij botimi, duke përfshirë
tekstin dhe fotot e përdorura, i takojnë Gjykatës së Lartë.
Tiranë, 2026

Përgatiti Aulona Hazbiu
Faqosja dhe kopertina Maluka print
Shtypur në Shqipëri nga “Maluka”

Ky botim u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe
të Këshillit të Evropës. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit.
Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se
pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



COUNCIL OF EUROPE



Bashkëfinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës

VËLLIMI IV:

**VENDIME TË PËRZGJEDHURA TË GJYKATËS EVROPIANETË TË
DREJTAVE TË NJERIUT (GJEDNJ) NË LIDHJE ME GJYKATËN E LARTË**

TABELA PËRMBLEDHËSE

FJALË HYRËSE	12
---------------------------	-----------

I. Vendime të përzgjedhura të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ):	20
---	-----------

Deri më qershor 2026:

1. Koboçi kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 55784/21, vendim i datës 16.06.2026 (arsyetim i kufizuar i Gjykatës së Lartë).....	21
2. Lepuri dhe të tjerë kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 17829/23, vendim i datës 31.03.2026 (afati i ankimit kushtetues: njoftim efektiv i vendimi të Gjykatës së Lartë)	23
3. Zyberi kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 24267/16, vendim i datës 27.01.2026 (ndërhyrje e autoriteteve administrative ose gjyqësore pas dhënies së një vendimi përfundimtar).....	24

Për vitin 2025:

4. Ibrahim i dhe të tjerë kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 81057/17, vendim i datës 14.01.2025 (afati i ankimit kushtetues: njoftim efektiv i vendimit të Gjykatës së Lartë)	27
5. Gëllçi kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 15468/23, vendim i datës 25.02.2025 (proporcionaliteti i masës së sigurimit personal (arrest me burg)	28
6. Fortuzi kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 29237/18, vendim i datës 22.04.2025 (afati i ankimit kushtetues: njoftim efektiv i vendimit të Gjykatës së Lartë)	30
7. ARB SHPK dhe tre të tjerë kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 38860/19, vendim i datës 27.05.2025 (kohëzgjatje e procedurave gjyqësore: efektiviteti real i mjetit për përshpejtim ose kompensim)	31
8. Ismailaj dhe të tjerë, kërkesa nr. 28873/22, vendim i datës 08.07.2025 (paanshmëria e gjyqtarit: pjesëmarrje në gjykim konfiskimi pasurie të paluajtshme çështje faktike/juridike të lidhura ngushtë)	33

9. Ilija kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 22824/20, vendim i datës 15.07.2025 (afati i ankimit kushtetues: barra për administrimin/provimin e njoftimit)	35
10. Kotherja kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 51135/22, vendim i datës 02.10.2025 (siguria juridike: zbatim i menjëhershëm i rregullave të reja procedurale për çështjet në shqyrtim)	36
11. Rarani dhe të tjerë kundër Shqipërisë kërkesa nr. 19017/18, vendim i datës 14.10.2025 (kuptimi i "Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji": arsyetimi mbi rivlerësimin e provave)	38
12. Lasku dhe të tjerë kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 6045/14, vendim i datës 18.11.2025 (siguria juridike: shfuqizimi proprio motu i vendimeve përfundimtare të KKKP)	39
13. Buzalli kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 385/22, vendim i datës 09.12.2025 (vendim papranueshmërie: shërim i mjeteve të brendshme).....	41

Për vitin 2024:

14. Vjola SH.P.K. kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 18076/12, vendim i datës 30.01.2024 (tejzgjatje e afatit të shqyrtimit në çështje-përfshirë kërkesat për masa të përkohshme)	42
15. Rexhepi SH.P.K. kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 44789/07, vendim i datës 13.02.2024 (shërimi i mjeteve juridike të brendshme-akses efektiv në gjykatë).....	44
16. Leka kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 60569/09, vendim i datës 05.03.2024 (parashikueshmëria e akuzës dhe ricilësimi juridik i saj).....	46
17. Iliria S.R.L. kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 31011/09, vendim i datës 05.03.2024 (Afati i arsyeshëm në procedurat për njohje vendimi arbitrazhi ndërkombëtar)	48
18. Biba kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 24228/18, vendim i datës 07.05.2024 (mbrojtja efektive e integritetit fizik të fëmijëve në institucionet arsimore)	50
19. Zela kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 33164/11, vendim i datës 11.06.2024 (Ekzekutimi i një urdhri shembjeje prone, pa kompensim dhe pa garanci efektive procedurale).....	51
20. Keta kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 9227/19, vendim i datës 11.06.2024 (arrest në flagrancë, informim/dijeni reale për arsyet e privimit nga liria)	54

21. Ramaj kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 17758/06,
vendim i datës 10.12.2024 (E drejta e pronësisë e
konfirmuar me vendim gjyqësor të formës së
prerë-probleme strukturore mosregjistrim prone) 56
22. Gaba kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 33369/17,
vendim i datës 17.12.2024 (siguria juridike: rishikim
i vendimit të formës së prerë- res judicata) 58

Për vitin 2023:

23. Hysa kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 52048/16,
vendim i datës 21.02.2023 (masë e sigurimit personal:
proporcionaliteti, individualizimi i arsyetimit, rrethana personale) 60
24. Supergrav Albania SH.P.K. kundër Shqipërisë,
kërkesa nr. 20702/18, vendim i datës 09.05.2023
(aksesi në gjykatë: zbatimi formalist afateve procedurale)..... 62
25. Lazaris kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 48806/06,
vendim i datës 20.06.2023 (parimi i barazisë së armëve:
detyrimi për verifikim të njoftimit palëve në mënyrë konkrete) 64
26. Zeqo dhe Seat SHPK kundër Shqipërisë,
kërkesat nr. 61445/12 dhe 53157/15,
vendim i datës 22.06.2023 (mosveprimi procedural
i Gjykatës së Lartë për periudhë të gjatë në çështje jo komplekse) 66
27. Prima SH.P.K. dhe Kozmai kundër Shqipërisë,
kërkesa nr. 33183/07, vendim i datës 19.09.2023
(standard e arsyetimit të vendimit) 68
28. Nuraj kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 35703/17,
vendim i datës 10.10.2023 (kufizimi i imunitetit shtetëror
në mosmarrëveshje pune)..... 69
29. Durdaj dhe të tjerë kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 63543/09,
vendim i datës 07.11.2023 (pjesëmarrja efektive në
procesin penal e viktimave dhe familjarëve të tyre) 72
30. Prifti kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 56288/12,
vendim i datës 21.11.2023 (pretendimi për jurisprudence
kontradiktore të Gjykatës së Lartë-ekzistenca “dallimeve
të thella dhe afatgjata”) 74
31. Gurma kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 50249/13,
vendim i datës 28.11.2023 (afati i arsyeshëm:
kompleksitet i çështjes) 76

32. Osmani kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 8706/18,
vendim i datës 5.12.2023 (shpronësim de facto-kompensim
i plotë dhe i përshtatshëm për pronën).....78

Për vitin 2022:

33. Laçeç dhe të tjerë kundër Shqipërisë,
kërkesa nr. 22122/08, vendim i datës 29.09.2022
(afat i arsyeshëm: kompleksitet i çështjes)80

Për vitin 2021:

34. Bara dhe Kola kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 43391/18
dhe 17766/19, vendim i datës 12.10.2021
(afat i arsyeshëm: pasivitet procedural i Gjykatës së Lartë).....82
35. Laçi kundër Shqipërisë, kërkesë nr. 28142/17,
vendim i datës 19.10.2021 (aksesi në gjykatë:
proporcionaliteti-vlerësim real, i individualizuar
i gjendjes financiare).....84

Për vitin 2020:

36. Strazimiri kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 34602/16,
vendim i datës 21.01.2020 (trajtim çnjerëzor dhe poshtërues:
mungesa e institucioneve të specializuara për trajtimin
e personave me çrregullime mendore – pacientë forensikë)86

**PARATHËNIE E KRYETARIT TË GJYKATËS SË LARTË
SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**FOREWORD BY THE PRESIDENT OF THE SUPREME
COURT OF THE REPUBLIC OF ALBANIA**

I nderuar lexues,

Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut përbën sot një pjesë të pandashme të mënyrës se si kuptohet dhe zbatohet e drejta në një rend juridik evropian. Për shtetet palë në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vendimet e Gjykatës së Strasburgut nuk përfaqësojnë vetëm konstatime mbi respektimin ose cenimin e një të drejte në një çështje konkrete. Ato zhvillojnë standarde, saktësojnë përmbajtjen e garancive konvencionale dhe, mbi të gjitha, orientojnë institucionet kombëtare drejt një mbrojtjeje më efektive të të drejtave dhe lirive themelore.

Pikërisht në këtë këndvështrim duhet parë edhe ky botim, i cili përmbledh një pjesë të rëndësishme të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në çështjet kundër Shqipërisë. Përmes paraqitjes së vendimeve që prekin drejtpërdrejt ose tërthorazi funksionimin e sistemit gjyqësor shqiptar, botimi synon të ofrojë një instrument praktik për gjyqtarët, këshilltarët ligjorë, profesionistët e së drejtës dhe të gjithë ata që, në veprimtarinë e tyre, janë të thirrur të zbatojnë standardet e Konventës.

Një rëndësi të posaçme në këtë jurisprudencë kanë çështjet që lidhen me veprimtarinë e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese. Për shkak të pozicionit të tyre në rendin kushtetues, këto dy gjykata luajnë një rol vendimtar në sigurimin e mbrojtjes efektive të të drejtave themelore dhe në harmonizimin e së drejtës së brendshme me kërkesat e Konventës. Gjykata e Lartë, në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë ligji dhe në garantimin e zbatimit të njëtrajtshëm të së drejtës, dhe Gjykata Kushtetuese, si garantuese e Kushtetutës dhe e të drejtave kushtetuese, përbëjnë njëkohësisht hallkat e fundit të mbrojtjes gjyqësore në nivel kombëtar përpara se një çështje të mund të arrijë në Strasburg.

Jurisprudenca e përmbledhur në këtë botim dëshmon se marrëdhënia ndërmjet gjykatave kombëtare dhe Gjykatës Evropiane nuk mund të reduktohet në një raport kontrolli ndërmjet nivelit kombëtar dhe atij ndërkombëtar. Ajo është, para së gjithash, një marrëdhënie dialogu. Parimi i subsidiaritetit, mbi të cilin mbështetet sistemi i Konventës, vendos përgjegjësinë kryesore për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore mbi autoritetet kombëtare dhe, në mënyrë të veçantë, mbi gjykatat. Strasburgu ndërhyr pas mekanizmat e brendshëm kanë

vepruar; prandaj cilësia dhe efektiviteti i mbrojtjes së ofruar nga gjykatat kombëtare mbeten parakushti themelor për funksionimin e vetë sistemit të Konventës.

Vendimet e dhëna ndaj Shqipërisë gjatë viteve të fundit evidentojnë një evolucion domethënës edhe në natyrën e problematikave të shqyrtuara. Krahas çështjeve që historikisht kanë pasur karakter strukturor, si mbrojtja e pronës, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore apo kohëzgjatja e procedurave, jurisprudenca gjithnjë e më shumë është përqendruar te cilësia konkrete e procesit gjyqësor. Ajo prek çështje të tilla si aksesit efektiv në drejtësi, njoftimi i vendimeve, respektimi i afateve procedurale, arsyetimi gjyqësor, paanshmëria e trupit gjykues, kufijtë e kontrollit të ushtruar nga gjykata e ligjit, siguria juridike dhe efektiviteti real i mjeteve juridike.

Ky zhvillim ka një domethënie të veçantë për Gjykatën e Lartë. Standardet e Konventës nuk vënë në diskutim natyrën e saj si gjykatë kasacioni, funksionin e filtrimit të rekursit apo mundësinë e shqyrtimit të çështjeve në dhomë këshillimi dhe të përdorimit të një arsyetimi të përmbledhur kur natyra e çështjes e lejon. Ajo që kërkohet është që këto mekanizma të funksionojnë në mënyrë të parashikueshme, koherente dhe në respekt të thelbit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Në këtë kuptim, jurisprudenca e Strasburgut nuk kufizon funksionin e gjykatës së ligjit, por ndihmon në përcaktimin e standardeve brenda të cilave ky funksion ushtrohet me autoritet dhe legjitimitet të plotë.

Po aq e rëndësishme është marrëdhënia ndërmjet jurisprudencës së Gjykatës së Lartë dhe aksesit efektiv në Gjykatën Kushtetuese. Çështjet që lidhen me njoftimin e vendimeve dhe me llogaritjen e afateve të ankimit kushtetues kanë treguar në mënyrë të qartë se garancitë procedurale nuk funksionojnë të izoluara nga njëra-tjetra. Efektiviteti i mbrojtjes kushtetuese mund të varet edhe nga mënyra se si dokumentohet dhe komunikohet një vendim i gjykatës së zakonshme. Në këtë mënyrë, jurisprudenca e Gjykatës Evropiane nxit jo vetëm zhvillimin e standardeve brenda secilës gjykate, por edhe një ndërveprim institucional më të kujdesshëm ndërmjet juridiksioneve kombëtare.

Për gjykatat shqiptare, studimi i këtyre vendimeve ka rëndësi që shkon përtej zbatimit të detyrueshëm të një vendimi të veçantë të Gjykatës Evropiane. Vlera e jurisprudencës qëndron edhe në aftësinë e saj parandaluese. Njohja e standardit konvencional i mundëson gjyqtarit vendas që ta identifikojë problemin përpara se ai të shndërrohet në një

shkelje të Konventës. Kjo është edhe shprehja më e drejtpërdrejtë e subsidiaritetit: të drejtat e garantuara nga Konventa duhet të mbrohen, para së gjithash dhe në mënyrë efektive, brenda sistemit juridik kombëtar.

Nga kjo pikëpamje, vendimet në të cilat Gjykata Evropiane ka konstatuar shkelje kanë një vlerë të veçantë institucionale. Ato nuk duhen lexuar thjesht si një kritikë ndaj një vendimi apo institucioni të caktuar. Ato duhet të shërbejnë si mundësi për të identifikuar problematika, për të përmirësuar praktikën dhe për të parandaluar përsëritjen e tyre. Në të njëjtën mënyrë, vendimet në të cilat Gjykata Evropiane ka vlerësuar se mekanizmat dhe zgjidhjet e përdorura nga gjykatat shqiptare janë në përputhje me Konventën kanë rëndësi për konsolidimin e praktikave të mira dhe për krijimin e një standardi të qëndrueshëm kombëtar.

Në këtë kuptim, dialogu me jurisprudencën e Strasburgut është pjesë e kulturës institucionale të një gjyqësori modern. Aftësia e një gjykate për të reflektuar mbi praktikën e saj, për ta ballafaquar atë me standardet evropiane dhe, kur është e nevojshme, për ta zhvilluar më tej, nuk cenon pavarësinë e saj. Përkundrazi, ajo është shprehje e pjekurisë institucionale dhe e përgjegjësisë që shoqëron ushtrimin e pushtetit gjyqësor.

Për këtë arsye, Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë e konsideron këtë përmbledhje jo vetëm si një botim informues, por si një instrument pune. Qëllimi i saj është që jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të jetë më e aksesueshme dhe më e përdorshme në praktikën e përditshme gjyqësore, duke ndihmuar në identifikimin e standardeve që kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për procesin gjyqësor dhe për mbrojtjen efektive të të drejtave të individit.

Botimi realizohet me mbështetjen e Këshillit të Evropës, të cilit i shpreh mirënjohjen për bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme në forcimin e kapaciteteve të sistemit gjyqësor shqiptar dhe në promovimin e standardeve të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ky bashkëpunim merr një kuptim të veçantë kur rezultatet e tij shndërrohen në instrumente konkrete që mund të përdoren nga gjyqtarët dhe profesionistët e së drejtës në punën e tyre të përditshme.

Shpresoj që kjo përmbledhje të shërbejë jo vetëm si një burim referimi për jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ndaj Shqipërisë, por edhe si një nxitje për një lexim më të vazhdueshëm dhe më kritik të saj. Mbrojtja efektive e të drejtave të njeriut nuk realizohet

vetëm përmes normave që i njohin ato, por përmes një jurisprudence që i bën këto të drejta konkrete dhe efektive në çdo proces gjyqësor.

Në fund të fundit, autoriteti i një gjykate të lartë nuk buron vetëm nga finaliteti i vendimeve të saj. Ai mbështetet edhe në cilësinë e arsytimit, në koherencën e jurisprudence, në respektimin e standardeve të procesit të rregullt dhe në aftësinë e institucionit për të mësuar e për t'u zhvilluar vazhdimisht. Në këtë proces, jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut mbetet një pikë thelbësore referimi dhe një pjesë e rëndësishme e dialogut të përbashkët evropian mbi drejtësinë dhe shtetin e së drejtës.

SOKOL SADUSHI
Kryetar i Gjykatës së Lartë

Dear reader,

The case-law of the European Court of Human Rights has become an integral part of the European legal order and of the way in which fundamental rights are understood and given effect within it. For the States Parties to the European Convention on Human Rights, the judgments of the Strasbourg Court represent more than findings as to whether a particular right has been respected or infringed in an individual case. They develop legal standards, clarify the substance and scope of Convention guarantees and, above all, guide national institutions towards more effective protection of fundamental rights and freedoms.

It is precisely from this perspective that the present publication should be approached. It brings together a significant body of the case-law of the European Court of Human Rights in cases against Albania. By presenting judgments that bear, directly or indirectly, upon the functioning of the Albanian judicial system, the publication seeks to provide a practical resource for judges, legal advisers, legal practitioners and all those who, in the exercise of their professional responsibilities, are called upon to apply the standards of the Convention.

Of particular significance within this body of case-law are those cases concerning the activity of the Supreme Court and the Constitutional Court. By virtue of their respective positions within the constitutional order, these two courts play a decisive role in securing the effective protection of fundamental rights and in ensuring the alignment of domestic law with the requirements of the Convention. The Supreme Court, in the exercise of its function as a court of law and in safeguarding the uniform application of the law, and the Constitutional Court, as the guardian of the Constitution and constitutional rights, constitute the final instances of judicial protection at national level before a case may ultimately reach Strasbourg.

The case-law brought together in this publication demonstrates that the relationship between national courts and the European Court cannot be reduced to one of supervision between the domestic and international levels. It is, first and foremost, a relationship of judicial dialogue. The principle of subsidiarity, upon which the Convention system is founded, places primary responsibility for the protection of fundamental rights and freedoms upon the national authorities and, in particular, upon the

courts. Strasbourg intervenes once the domestic mechanisms have had the opportunity to operate; the quality and effectiveness of the protection afforded by national courts therefore remain a fundamental prerequisite for the proper functioning of the Convention system itself.

The judgments delivered in respect of Albania in recent years also reveal a significant evolution in the nature of the issues examined. Alongside matters that have historically been structural in character, such as the protection of property, the enforcement of judicial decisions and the length of proceedings, the case-law has increasingly focused on the actual quality of the judicial process. It now engages with matters such as effective access to justice, notification of judicial decisions, observance of procedural time-limits, judicial reasoning, the impartiality of judicial panels, the limits of review exercised by a court of law, legal certainty, and the practical effectiveness of legal remedies.

This development is of particular significance for the Supreme Court. Convention standards do not call into question its nature as a court of cassation, its function of filtering appeals on points of law, or its ability to examine cases in camera and to employ concise reasoning where the nature of the case so permits. What is required is that these mechanisms operate in a foreseeable and coherent manner, while preserving the very essence of the right to a fair trial. In this sense, the Strasbourg case-law does not constrain the function of the court of law; rather, it contributes to defining the standards within which that function may be exercised with full authority and legitimacy.

Equally important is the relationship between the case-law of the Supreme Court and effective access to the Constitutional Court. Cases concerning the notification of judicial decisions and the calculation of time-limits for lodging constitutional complaints have demonstrated clearly that procedural guarantees do not operate in isolation from one another. The effectiveness of constitutional protection may also depend upon the manner in which a decision of an ordinary court is documented and communicated. In this way, the case-law of the European Court fosters not only the development of standards within each court, but also a more attentive institutional interaction between the different national jurisdictions.

For the Albanian courts, the study of these judgments has a significance that extends beyond the binding execution of any individual judgment of

the European Court. The value of the case-law also lies in its preventive capacity. Acquaintance and understanding of Convention standards enable the national judge to identify a potential problem before it develops into a violation of the Convention. This is also the most direct expression of subsidiarity: the rights guaranteed by the Convention must, first and foremost, be protected effectively within the domestic legal system.

From this perspective, judgments in which the European Court has found a violation possess particular institutional value. They should not be read merely as criticism of a particular judgment or institution. Rather, they should serve as an opportunity to identify shortcomings, improve practices and prevent their recurrence. By the same token, judgments in which the European Court has found that the mechanisms and solutions adopted by the Albanian courts comply with the Convention are equally important for consolidating good practices and developing stable and consistent standards at national level.

In this sense, engagement with the Strasbourg case-law forms part of the institutional culture of a modern judiciary. A court's capacity to reflect upon its own practice, to assess that practice against European standards and, where necessary, to develop it further does not detract from its independence. On the contrary, it is an expression of institutional maturity and of the responsibility inherent in the exercise of judicial power.

For this reason, the Supreme Court of the Republic of Albania regards this collection not merely as an informative publication, but as a practical working instrument. Its purpose is to make the case-law of the European Court more accessible and readily applicable in everyday judicial practice, thereby facilitating the identification of standards of direct relevance to judicial proceedings and to the effective protection of individual rights.

This publication has been prepared with the support of the Council of Europe, to which I wish to express my gratitude for its cooperation and continued support in strengthening the capacities of the Albanian judicial system and promoting the standards of the European Convention on Human Rights. Such cooperation assumes particular significance when its results are translated into practical instruments that judges and legal professionals can employ in their daily work.

I hope that this collection will serve not only as a source of reference on the case-law of the European Court of Human Rights concerning

Albania, but also as an encouragement towards its more sustained and critical engagement. The effective protection of human rights is secured not merely through legal norms that recognise those rights, but through a body of jurisprudence that renders them practical and effective in every judicial process.


Ultimately, the authority of a supreme court derives not solely from the finality of its judgments. It rests equally upon the quality of its reasoning, the coherence of its case-law, its observance of fair-trial standards, and the institution's capacity to learn and to evolve continuously. In that process, the case-law of the European Court of Human Rights remains an essential point of reference and an important part of the shared European judicial dialogue on justice and the rule of law.

SOKOL SADUSHI
President of the Supreme Court

VËLLIMI IV:

**VENDIME TË PËRZGJEDHURA TË GJYKATËS EVROPIANETË TË
DREJTAVE TË NJERIUT (GJEDNJ) NË LIDHJE ME GJYKATËN E LARTË**

Deri më qershor 2026



**1. Koboçi kundër Shqipërisë,
kërkesa nr. 55784/21,
vendim i datës 16 qershor 2026**

Arsyetim i kufizuar i Gjykatës së Lartë

Maksima – 1. Një vendim i Gjykatës së Lartë që deklaron të papranueshëm rekursin nuk është në kundërshtim me nenin 6 § 1 të Konventës vetëm për shkak se përmban një arsyetim të kufizuar, për sa kohë që ai mbështetet në një bazë ligjore të qartë dhe nuk rezulton arbitrar. 2. Po kështu, prishja e një ndërtimi të paligjshëm dhe refuzimi i kompensimit për pronarin nuk cenon në nenin 1 të Protokollit nr. 1 kur autoritetet kombëtare kanë vendosur një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesit publik dhe të drejtave të individit.

Fjalë kyçe - Neni 6 § 1 KEDNJ, e drejta për një vendim të arsyetuar, rekursi, papranueshmëria e rekursit, arsyetim i kufizuar, neni 1 i Protokollit nr. 1 KEDNJ, gëzimi paqësor i pasurisë, ndërtim i paligjshëm, prishja e objektit, kompensimi.

Koboçi v. Albania, application no. 55784/21, decision of 16 June 2026

Limited reasoning by the Supreme Court

Legal principle(s) – 1. A decision of the Supreme Court declaring an appeal on points of law inadmissible is not incompatible with Article 6 § 1 of the Convention merely because it contains limited reasoning, provided that it is based on a clear legal basis and does

not appear arbitrary. 2. Likewise, the demolition of an unlawful construction and the refusal to award compensation to its owner do not constitute a violation of Article 1 of Protocol No. 1 where the domestic authorities have struck a fair balance between the public interest and the rights of the individual.

Keywords – Article 6 § 1 ECHR; right to a reasoned decision; appeal on points of law; inadmissibility of an appeal on points of law; limited reasoning; Article 1 of Protocol No. 1 ECHR; peaceful enjoyment of possessions; unlawful construction; demolition; compensation.

Përmbledhje – Çështja ka të bëjë me prishjen e një ndërtese, përfshirë katin përdhes në pronësi të ankuesit, si ndërtim pa leje, si edhe me refuzimin e kërkesës së tij për dëmshpërblim. Ankuesi pretendoi shkeljen e nenit 6 § 1 të Konventës për mungesë arsyetimi të vendimit të Gjykatës së Lartë dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 për cenimin e së drejtës së pronës. Në lidhje me nenin 6 § 1, GJEDNJ ritheksoi se, ndonëse gjykatat janë të detyruara të japin arsye për vendimet e tyre, kjo nuk nënkupton detyrimin për t’iu përgjigjur në mënyrë të detajuar çdo argumenti të palëve. Veçanërisht, kur një gjykatë e lartë deklaron një rekurs të papranueshëm duke zbatuar një dispozitë të posaçme procedurale, Konventa nuk kërkon një arsyetim të zgjeruar. Për pasojë, ajo nuk gjeti elemente arbitrariteti apo mungesë të tillë arsyetimi që të cenonin garancitë e nenit 6 § 1. Sa i përket nenit 1 të Protokollit nr. 1, Gjykata vlerësoi se, pavarësisht pretendimeve mbi pavlefshmërinë e titullit të pronësisë, ankuesi gëzonte një “posedim” në kuptim të Konventës, pasi kishte blerë pronën me kontratë dhe e kishte regjistruar atë në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Gjykata theksoi se prishja e ndërtimeve pa leje përbën një masë të kontrollit të përdorimit të pronës, e cila mund të justifikohet nga interesi publik për zbatimin e rregullave urbanistike, për sa kohë është e ligjshme dhe proporcionale. Në analizën e proporcionalitetit, Gjykata vuri në dukje se gjykatat vendase kishin konstatuar se e gjithë ndërtesa ishte ndërtuar pa leje, se regjistrimi kadastral nuk është kusht për vlefshmërinë e titullit të pronësisë në sistemin shqiptar, se ankuesi nuk kishte provuar se autoritetet kishin toleruar ndërtimin dhe se ai nuk kishte kërkuar përgjegjësi civile nga shitësi i pronës. Në këto rrethana, Gjykata arriti në përfundimin se prishja e objektit nuk kishte vendosur mbi ankuesin një barrë individuale të tepruar, ndaj ankimi u shpall haptazi i pabazuar.



2. Lepuri dhe të tjerë kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 17829/23 dhe të tjera, vendim i datës 31 mars 2026

Afati i ankimit kushtetues: njoftim efektiv i vendimit të Gjykatës së Lartë

Maksima - Afati për ushtrimin e një ankese kushtetuese fillon nga momenti i njoftimit efektiv të vendimit të Gjykatës së Lartë tek pala kërkuuese dhe jo nga data e marrjes së vendimit nga gjykata. Barra për të provuar datën e njoftimit i takon kryesisht autoritetit gjyqësor e jo palës.

Fjalë kyçe – afat, ankim kushtetues, njoftim efektiv, datë e marrjes së vendimit, barra e provës

Lepuri and Others v. Albania, application no. 17829/23 and others, judgment of 31 March 2026

Time limit for constitutional appeal - effective notification of the decision of the Supreme Court

Legal principle(s): The time limit for filing a constitutional appeal starts from the moment of effective notification of the decision of the Supreme Court to the requesting party and not from the date of the decision taken by the court. The burden of proof regarding notification lies primarily with the judicial authority and not with the party.

Keywords: time limit, constitutional appeal, effective notification, date of decision, burden of proof

Përmbledhje - Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut shqyrtoi në këto ankese çështjen e aksesit në Gjykatën Kushtetuese në kuptim të nenit 6 § 1 të Konventës, veçanërisht lidhur me mënyrën e llogaritjes së afatit katërmujor për paraqitjen e ankesës kushtetuese. Konkretisht, çështjet lidhen me praktikën e gjykatave vendase për ta llogaritur këtë afat nga data e marrjes së vendimit të Gjykatës së Lartë, dhe jo nga momenti kur aplikantët kishin marrë dijeni efektive për të. Gjykata konstatoi se interpretimi i këtij afat procedural kishte privuar kërkuuesit nga një akses efektiv në gjykimin kushtetues. Për më tepër, gjykata vlerësoi se barra e provës për të vërtetuar momentin e njoftimit efektiv nuk mund t'u ngarkohej palëve,

por përbën një përgjegjësi parësore të autoriteteve shtetërore, të cilat duhet të garantojnë njoftimin e rregullt dhe të provueshëm të vendimeve gjyqësore. Duke iu referuar gjithashtu jurisprudencës së saj në çështjet *Supergrav Albania SHPK kundër Shqipërisë dhe Zela kundër Shqipërisë*, gjykata arriti në përfundimin se interpretimi dhe zbatimi i këtij afati nga gjykatat shqiptare cenoi thelbin e së drejtës për akses në gjykatë, duke përbërë kështu shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.



3. Zyberi kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 24267/16, vendim i datës 27 janar 2026

Ndërhyrje e autoriteteve administrative ose gjyqësore pas dhënies së një vendimi përfundimtar

Maksima- 1. Një vendim gjyqësor i formës së prerë nuk mund të neutralizohet në fazën e ekzekutimit përmes ndërhyrjeve administrative ose procedurave të reja, pa u cenuar parimi i res judicata. 2. Ndërhyrja e autoriteteve administrative ose gjyqësore, pas dhënies së një vendimi përfundimtar, që e bën atë të pazbatueshëm në praktikë, përbën shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1, në mungesë të arsyeve bindëse dhe të jashtëzakonshme.

Fjalë kyçe – vendim përfundimtar i formës së prerë, ndërhyrje administrative, procedura të reja, res judicata, vendim i paekzekutueshëm në praktikë. Neni 6 § 1 KEDNJ, Neni 1 i Protokollit nr. 1 KEDNJ.

Zyberi v. Albania, application no. 24267/16, judgment dated 27 January 2026

Intervention of administrative or judicial authorities following a final decision

Legal principle(s)- 1. A final and binding judicial decision cannot be neutralised at the enforcement stage through administrative intervention or the initiation of new proceedings in a manner that undermines the principle of res judicata. 2. Any interference by administrative or judicial authorities following the delivery of a final decision, which renders that decision unenforceable in practice, constitutes a violation of Article 6 § 1 of the Convention and

Article 1 of Protocol No. 1.

Keywords: *final and binding judicial decision; administrative intervention; new proceedings; res judicata; unenforceable decision in practice; Article 6 § 1 of the ECHR; Article 1 of Protocol No. 1 to the ECHR.*

Përmbledhje - Çështja lidhet me një pronë të kthyer në favor të kërkuesses në vitet 1994–1995, posaçërisht një sipërfaqe toke të regjistruar në ZVRPP, në të cilën u ndërtua pa leje nga X dhe familjarët e tij. Në vijim të proceseve gjyqësore të nisura nga kërkuessa për lirimin dhe dorëzimin e truallit, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendim të vitit 2009, të lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë në vitin 2011, urdhëroi X të lironte dhe t'i dorëzonte kërkuesses sipërfaqen e zënë në mënyrë të paligjshme. Ky vendim u bë titull ekzekutiv dhe kërkuessa nisi procedurat përmbartimore për ekzekutimin e tij. Megjithatë, ndërkohë që procesi gjyqësor mbi lirimin e truallit ishte ende në shqyrtim në Gjykatën e Lartë, X përfitoi nga procedurat administrative të legalizimit sipas legjislacionit për ndërtimet informale. Në vitin 2011, autoritetet administrative legalizuan ndërtimin dhe i kaluan atij pronësinë mbi parcelën përkatëse, ndonëse toka ishte e regjistruar në emër të kërkuesses dhe objekt i një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Kërkuessa kundërshtoi legalizimin në gjykatë, por këto procese mbetën në zhvillim për një periudhë të gjatë dhe pa një zgjidhje përfundimtare në kohën kur u pezullua ekzekutimi.

Në procedurat e treta, Gjykata e Rrethit Vlorë pranoi kërkesën e X për pezullimin e ekzekutimit duke u mbështetur në legalizimin e ndërtimit të tij në vitin 2011, të cilin e trajtoi si një fakt të ri të lindur pas vendimit përfundimtar të vitit 2009. Ajo arsyetoi se kushtet për ekzekutimin kishin ndryshuar, pasi X ishte bërë pronar i ligjshëm i truallit, duke e vendosur atë në të njëjtën pozitë juridike me paditësen, dhe se ekzekutimi do të cenonte të drejtat e tij si pronar. Gjykata Evropiane konstatoi se ky arsyetim ishte kontradiktor dhe i pambështetur, pasi legalizimi ishte kryer mbi një pronë private të regjistruar, të trajtuar gabimisht nga autoritetet si tokë shtetërore, ndërsa procedurat për kundërshtimin e legalizimit ishin ende në pritje. Gjykata vlerësoi gjithashtu se gjykatat vendase rivlerësuan elemente thelbësore faktike të çështjes, përfshirë identifikimin e personit që kishte ndërtuar dhe sipërfaqen konkrete të zaptuar, çështje që ishin zgjidhur përfundimisht me vendimin e vitit 2009. Në këtë mënyrë, ato kryen në thelb një rishqyrtim material të maskuar të një vendimi të formës së prerë, duke cenuar parimin e res judicata dhe sigurinë juridike. Si

pasojë e pezullimit dhe bllokimit përfundimtar të ekzekutimit, vendimi i vitit 2009 u bë praktikisht i pazbatueshëm, çka çoi në konstatimin nga GJEDNJ të shkeljes së nenit 6 § 1 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1.

Për vitin 2025



4. Ibrahimimi dhe të tjerë kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 81057/17, vendim i datës 14 janar 2025

Afati i ankimit kushtetues: njoftim efektiv i vendimit të Gjykatës së Lartë

Maksima – 1. E drejta për akses efektiv në Gjykatën Kushtetuese cenohet kur afati për paraqitjen e ankimit kushtetues llogaritet nga data e dhënies së vendimit të Gjykatës së Lartë dhe jo nga momenti i marrjes dijeni efektive nga pala. 2. Barra për të administruar dhe provuar datën e njoftimit të vendimeve gjyqësore i takon autoriteteve gjyqësore, veçanërisht Gjykatës së Lartë, dhe jo palëve ndërgjyqëse.

Fjalë kyçe – akses në Gjykatën Kushtetuese, afati katërmujor, njoftimi i vendimit gjyqësor, marrja dijeni efektive, neni 6 § 1 KEDNJ, Gjykata e Lartë, barra e provës

Ibrahimimi and Others v. Albania, application No. 81057/17, judgment of 14 January 2025

Time limit for constitutional appeal: effective notification of the Supreme Court decision

Legal principle(s) – 1. The right to effective access to the Constitutional Court is violated when the time limit for filing a constitutional appeal is calculated from the date of delivery of the Supreme Court decision and not from the moment of effective notification to the party. 2. The burden of administering and proving the date of notification of judicial decisions lies with the judicial authorities, in particular the Supreme Court, and not with the litigants.

Keywords – access to the Constitutional Court, four-month time limit, notification of the judicial decision, effective notification, Article 6 § 1 ECHR, Supreme Court, burden of proof

Përmbledhje - Çështja bashkoi pesë kërkesa të ndryshme civile dhe penale, të cilat kishin të përbashkët faktin se Gjykata Kushtetuese kishte shpallur të papranueshme ankimet kushtetuese të kërkuësve si të paraqitura jashtë afatit katërmujor. Në të gjitha rastet, Gjykata Kushtetuese e kishte llogaritur afatin nga data e dhënies së vendimit të Gjykatës së Lartë dhe jo nga data kur kërkuësit kishin marrë dijeni efektive për të. Kërkuësit provuan se vendimet e Gjykatës së Lartë u ishin dorëzuar muaj ose vite pas shpalljes së tyre. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese arsyetoi se vulat e vendosura mbi vendimet nuk provonin datën e parë të njoftimit dhe se barra për të provuar mungesën e një njoftimi më të hershëm i takonte vetë palëve. GJEDNJ konstatoi se kjo mënyrë interpretimi e afatit procedural cenonte të drejtën e aksesit në Gjykatën Kushtetuese sipas sipas nenit 6 § 1 të Konventës. Gjykata theksoi se barra për administrimin dhe provimin e datës së njoftimit të vendimeve gjyqësore i takon kryesisht Gjykatës së Lartë dhe jo palëve ndërgjyqëse. Gjykata vlerësoi gjithashtu se, për shkak të këtij konstatimi, kërkuësit kishin mundësinë të kërkonin rihapjen e procedurave pranë Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin në themel të pretendimeve të tyre të tjera për proces të rregullt ligjor.



**5. Gëllçi kundër Shqipërisë,
kërkesa nr. 15468/23,
vendim i datës 25 shkurt 2025**

Proporcionaliteti i masës së sigurimit personal (arrest në burg)

Maksima – 1. Vazhdimi i paraburgimit pas fazës fillestare kërkon arsye konkrete, relevante dhe të mjaftueshme; referimet abstrakte ndaj rëndësisë së veprës penale ose rrezikut të manipulimit të provave nuk mjaftojnë sipas nenit 5 § 3 të Konventës. 2. Gjykatat kanë detyrimin të vlerësojnë në mënyrë reale dhe të arsyetuar mundësinë e zbatimit të masave alternative më pak kufizuese ndaj lirisë personale.

Fjalë kyçe – arrest në burg, paraburgim, neni 5 § 3 KEDNJ, dyshim i arsyeshëm, proporcionaliteti, masë alternative siguri

Gëllçi v. Albania, application no. 15468/23, judgment of 25 February 2025

Proportionality of the pre-trial detention measure

Legal principle(s): 1. The continuation of pre-trial detention beyond the initial stage requires concrete, relevant and sufficient reasons. Abstract references to the seriousness of the criminal offence or to the risk of interference with evidence are not sufficient to satisfy the requirements of Article 5 § 3 of the Convention. 2. The courts are required to assess, in a genuine and reasoned manner, whether less restrictive alternative security measures could be applied instead of continued detention.

Keywords: prison detention, pre-trial detention; Article 5 § 3 of the ECHR; reasonable doubt; proportionality; alternative security measure.

Përmbledhje - Çështja ka të bëjë me masën e sigurimit “arrest në burg” të vendosur ndaj kërkuesit, ish-drejtor i RTSH-së, në kuadër të një procedimi penal për shpërdorim detyre lidhur me procedura tenderimi publik. Gjykatat vendase arsyetuan ndalimin me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, rrezikun e manipulimit të provave dhe dëshmitarëve, si dhe rrezikun e largimit të kërkuesit. Kërkuesi kundërshtoi vazhdimisht masën, duke argumentuar se provat ishin kryesisht dokumentare dhe tashmë të sekuestruara, se ai ishte larguar më parë jashtë vendit dhe ishte kthyer vullnetarisht në Shqipëri, si dhe se masa më të lehta sigurimi do të ishin të mjaftueshme. Megjithatë, gjykatat vendase vazhduan arrestin në burg me arsyetime të përgjithshme dhe pa analizuar konkretisht situatën individuale të kërkuesit apo alternativat më pak kufizuese. GJEDNJ konstatoi se, megjithëse ekzistonte dyshimi i arsyeshëm për kryerjen e veprës penale, gjykatat shqiptare nuk dhanë arsye “relevante dhe të mjaftueshme” për vijimin e paraburgimit për rreth shtatë muaj e njëzet e gjashtë ditë. Gjykata theksoi se autoritetet nuk identifikuan konkretisht provat që rrezikoheshin të manipuloheshin, nuk shpjeguan pse ato nuk ishin marrë më herët dhe nuk vlerësuan siç duhet rrethanat personale të kërkuesit apo mundësinë e masave alternative. Për këto arsye, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 5 § 3 të Konventës.



6. Fortuzi kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 29237/18, vendimi i datës 22 prill 2025

Afati i ankimit kushtetues: njoftim efektiv i vendimit të Gjykatës së Lartë

Maksima – 1. Tejzgjatja e pajustificuar e procedurave gjyqësore cenon të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm sipas nenit 6 § 1 të Konventës. 2. E drejta për akses efektiv në Gjykatën Kushtetuese cenohet kur afati për paraqitjen e ankimit kushtetues llogaritet nga data e dhënies së vendimit të Gjykatës së Lartë dhe jo nga momenti i marrjes dijeni efektive të tij nga pala. 3. Barra për provimin e njoftimit të vendimit i takon autoriteteve gjyqësore.

Fjalë kyçe – afati i arsyeshëm, tejzgjatja e procedurave, neni 6 § 1 KEDNJ, akses në Gjykatën Kushtetuese, marrja dijeni efektive, njoftimi i vendimit gjyqësor

Fortuzi v. Albania, application no. 29237/18, judgment of 22 April 2025


Time limit for lodging a constitutional appeal: effective notification of the Supreme Court's decision

Legal principle(s): 1. The unjustified excessive length of judicial proceedings violates the right to a hearing within a reasonable time under Article 6 § 1 of the Convention. 2. The right to effective access to the Constitutional Court is violated where the time limit for lodging a constitutional appeal is calculated from the date on which the Supreme Court's decision was delivered, rather than from the date on which the party effectively became aware of that decision. 3. The burden of establishing that the judicial decision was duly notified lies with the judicial authorities.

Keywords: reasonable time; excessive length of proceedings; Article 6 § 1 of the ECHR; access to the Constitutional Court; effective knowledge of the decision; notification of a judicial decision

Përmbledhje - Çështja ka të bëjë me kohëzgjatjen e procedurave administrative dhe civile për kthimin e pronës, si edhe me të drejtën e

kërkuesit për akses në Gjykatën Kushtetuese. Kërkuesi kishte nisur procedurat në vitin 1995 për të kundërshtuar refuzimin e kërkesës së tij për kthimin e një prone, ndërsa procesi gjyqësor civil përfundoi vetëm në vitin 2017, pas shqyrtimit në katër nivele juridiksioni. GJEDNJ vlerësoi se procedurat gjyqësore kishin zgjatur rreth shtatë vjet e shtatë muaj dhe se vonesat ishin rënduar nga mungesa e njoftimit në kohë të vendimeve të Gjykatës së Apelit dhe veçanërisht të Gjykatës së Lartë. Vendimi i Gjykatës së Lartë i vitit 2015 nuk iu njoftua kërkuesit dhe ai mori dijeni për të vetëm në qershor 2017. Pas marrjes dijeni, kërkuesi paraqiti ankim kushtetues brenda afatit katërmujor të parashikuar nga ligji i ri. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese e rrëzoi ankimin si jashtë afatit, duke e llogaritur afatin nga data e dhënies së vendimit të Gjykatës së Lartë dhe jo nga data e njoftimit të tij. GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës si për kohëzgjatjen e paarsyeshme të procedurave, ashtu edhe për cenimin e së drejtës së aksesit në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata theksoi se barra për të administruar dhe provuar datën e njoftimit të vendimeve gjyqësore i takon autoriteteve gjyqësore, veçanërisht Gjykatës së Lartë.



7. ARB SHPK dhe tre të tjerë kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 38860/19, vendim i datës 27 maj 2025

Kohëzgjatje e procedurave gjyqësore: efektiviteti real i mjetit për përshpejtim ose kompensim

Maksima – 1. Problemet strukturore të sistemit gjyqësor, përfshirë reformën në drejtësi dhe backlog-un, nuk e përjashtojnë shtetin nga detyrimi për të garantuar gjykim brenda një afati të arsyeshëm sipas nenit 6 § 1 të Konventës. 2. Një mjet juridik për ankesat mbi kohëzgjatjen e procedurave është efektiv nëse jo vetëm ekziston në ligj, por funksionon realisht në praktikë duke përshpejtuar procedurat ose duke ofruar kompensim efektiv brenda një kohe të arsyeshme.

Fjalë kyçe – probleme strukturore, afati i arsyeshëm, kohëzgjatja e procedurave, reforma në drejtësi, neni 6 § 1 KEDNJ, neni 13 KEDNJ, mjet efektiv juridik, përshpejtimi i procedurave, kompensim për vonesa gjyqësore.

ARB shpk and Others v. Albania, application no. 38860/19, judgment of 27 May 2025

Length of judicial proceedings: effectiveness of the remedy for acceleration or compensation

Legal principle(s): 1. Structural problems affecting the judicial system, including those arising from the judicial reform and the backlog of cases, do not absolve the State from its obligations under Article 6 § 1 of the Convention to ensure that proceedings are concluded within a reasonable time. 2. A legal remedy concerning the excessive length of proceedings is effective only when it is available not merely in law but also operates effectively in practice, either by accelerating the proceedings or providing adequate compensation within a reasonable time.

Keywords: structural problems; reasonable time; length of proceedings; judicial reform; Article 6 § 1 of the ECHR; Article 13 of the ECHR; effective legal remedy; acceleration of proceedings; compensation for judicial delays.

Përmbledhje - Çështja ka të bëjë me tejzgjatjen e procedurave gjyqësore në Shqipëri dhe efektivitetin në praktikë të mjetit juridik të krijuar në vitin 2017 për ankesat mbi tejzgjatjen e proceseve gjyqësore. Katër kërkuesit ankoheshin kryesisht për vonesat shumëvjeçare pranë Gjykatës së Lartë dhe gjykatave administrative, si edhe për mungesën e një mjeti realisht efektiv për përshpejtimin ose kompensimin e këtyre vonesave. Në dy kërkesat e para, procesi civil kishte qëndruar për vite të tëra pezull pranë Gjykatës së Lartë. Edhe pse kërkuesit përdorën mekanizmin e nenit 399/1 të Kodit të Procedurës Civile për konstatimin e shkeljes së “afatit të arsyeshëm”, Gjykata e Lartë dhe më pas Gjykata Kushtetuese refuzuan të gjenin shkelje, duke u mbështetur kryesisht në pasojat sistemike të reformës në drejtësi dhe backlog-un e krijuar nga procesi i vetting-ut. Në kërkesën e katërt, Gjykata Kushtetuese konstatoi shkelje të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm dhe urdhëroi Gjykatën e Lartë të shqyrtonte çështjen brenda gjashtë muajve. Megjithatë, edhe procedurat për kompensimin e kërkuesit për vonesën u zvarritën përtej afateve ligjore dhe vendimi i kompensimit nuk u ekzekutua menjëherë. GJEDNJ vlerësoi se vonesat shumëvjeçare pranë Gjykatës së Lartë dhe gjykatave administrative tejkalonin kërkesën e “afatit të arsyeshëm” sipas nenit 6 § 1 të Konventës. Ajo theksoi se problemet strukturore të sistemit gjyqësor, përfshirë vetting-un, mungesat në trupën gjyqësore dhe backlog-un, nuk e çlironin shtetin nga detyrimi për të organizuar sistemin gjyqësor në

mënyrë që gjykatat të garantonin gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Gjykata konstatoi gjithashtu se mjeti i vitit 2017 ishte efektiv në parim, por jo gjithmonë efektiv në praktikë, sidomos kur vetë procedurat për përsheptimin ose kompensimin zgjateshin në mënyrë të pajustificuar. Për këtë arsye, në lidhje me kërkesën e katërt, GJEDNJ konstatoi edhe shkelje të nenit 13 të Konventës për mungesë të një mjeti efektiv juridik.



**8. Ismailaj dhe të tjerë kundër Shqipërisë,
kërkesa nr. 28873/22,
vendim i datës 8 korrik 2025**

Paanshmëria e gjyqtarit: pjesëmarrje në gjykim konfiskimi pasurie të paluajtshme çështje faktike/juridike të lidhura ngushtë

Maksima – 1. Pjesëmarrja në gjykim e një gjyqtari që është shprehur më parë mbi çështje thelbësore faktike dhe juridike të procedurave të lidhura ngushtë me të njëjtin subjekt dhe të njëjtën bazë hetimore cenon garancinë e paanshmërisë objektive sipas nenit 6 § 1 të Konventës. 2. Kur ekziston një arsye objektive dhe justifikuar për të dyshuar mbi paanshmërinë e një gjyqtari, ai ka detyrimin të tërhiqet vetë nga gjykimi ose, të paktën, t'u bëjë të njohur palëve rrethanat përkatëse, në mënyrë që ato të mund të kërkojnë përjashtimin e tij në kohën e duhur.

Fjalë kyçe - paanshmëria e gjyqtarit, proces i rregullt ligjor, sekuestro asetesh, dhomë këshillimi, kërkesë për përjashtim, masa të posaçme, rihapje e procesit, neni 46 KEDNJ

***Ismailaj and Others v. Albania, application no. 28873/22,
judgment of 8 July 2025***

Impartiality of judges: participation in confiscation proceedings involving closely related factual and legal issues

Legal principle(s): 1. The participation in proceedings of a judge who has previously expressed views on essential factual and legal issues arising from proceedings closely connected with the same subject matter and the same underlying investigation undermines the guarantee of objective impartiality under Article 6 § 1 of the Convention. 2. Where there are objectively justified grounds for doubting a judge's impartiality, the judge is required to withdraw

from the proceedings or, at a minimum, to disclose the relevant circumstances to the parties so that they may seek the judge's disqualification in a timely manner.

Keywords: *judicial impartiality; fair trial; seizure of assets; deliberative chamber; request for disqualification; special measures; reopening of proceedings; Article 46 of the ECHR.*

Përmbledhja - Çështja ka të bëjë me procedurat e konfiskimit të pasurive ndaj kërkuesve sipas ligjit antimafia. Në kuadër të dy procedurave të veçanta për konfiskimin e pasurive, gjykatat vendase konstatuan se kërkuesi i parë dhe kompania e tij kishin kryer transaksione financiare të pajustificuara dhe se pasuritë e konfiskuara kishin origjinë të paligjshme. Në grupin e parë të procedurave, në vitin 2016, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me pjesëmarrjen e gjyqtarit K.K., urdhëroi konfiskimin e disa llogarive bankare të kërkuesve. Më pas, në grupin e dytë të procedurave, që kishte të bënte me konfiskimin e pasurive të tjera, i njëjti gjyqtar mori pjesë si anëtar i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që shqyrtoi rekursin e kërkuesve dhe e deklaroi atë të papranueshëm. Kërkuesit pretenduan se pjesëmarrja e gjyqtarit K.K. në gjykimin në Gjykatën e Lartë cenonte paanshmërinë objektive të gjykatës, pasi ai ishte shprehur më parë mbi çështje thelbësore faktike dhe juridike të lidhura ngushtë me të njëjtin hetim penal dhe me të njëjtat pretendime për origjinën e paligjshme të pasurive. GJEDNJ konstatoi se të dy grupet e procedurave mbështeteshin në të njëjtat fakte, të njëjtin hetim penal dhe në çështje juridike thelbësisht të lidhura, pavarësisht se kishin objekt pasuri të ndryshme. Gjykata vlerësoi se ekzistonin dyshime objektivisht të justifikuara që gjyqtari K.K. mund të kishte krijuar paraprakisht një opinion mbi meritat e çështjes, duke qenë se ai kishte marrë pjesë më herët në konfiskimin e pasurive të të njëjtëve kërkues mbi të njëjtën bazë faktike dhe ligjore. Gjykata theksoi gjithashtu se kërkuesit nuk ishin njoftuar paraprakisht për përbërjen e trupit gjykues të Gjykatës së Lartë dhe se nuk ishte marrë asnjë masë për t'u dhënë mundësinë të kërkonin përjashtimin e gjyqtarit. Për më tepër, edhe pse Gjykata e Lartë e deklaroi rekursin të papranueshëm, ajo u shpreh në një masë të caktuar edhe mbi meritat e çështjes, duke vlerësuar se kushtet ligjore për konfiskimin ishin përmbushur. Në këto rrethana, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 të Konventës për shkak të mungesës së paanshmërisë së trupës gjykuese dhe vlerësoi se masa më e përshtatshme për korrigjimin e shkeljes ishte rihapja ose rigjykimi i procedurave, nëse kërkohet nga kërkuesit. Në lidhje me kërkesën për rihapjen e procesit, Gjykata vlerësoi se ndonëse neni 46 i Konventës i lë shteteve anëtare një

hapësirë për të përcaktuar mënyrën më të përshtatshme të zbatimit të masave individuale, rihapja e procesit përbën një mundësi të parashikuar brenda sistemit ligjor shqiptar dhe mbetet një mekanizëm i ligjshëm për zbatimin e këtij vendimi.



**9. Ilia kundër Shqipërisë,
kërkesa nr. 22824/20,
vendim i datës 15 korrik 2025**

Afati i ankimit kushtetues: barra për administrimin/provimin e njoftimit

Maksima – 1. *E drejta për akses efektiv në Gjykatën Kushtetuese cenohet kur afati për paraqitjen e ankimit kushtetues llogaritet nga data e dhënies së vendimit të Gjykatës së Lartë dhe jo nga data e njoftimit efektiv të tij ndaj palës, në mungesë të provave të qarta dhe të verifikueshme mbi datën e njoftimit.* 2. *Barra për administrimin dhe provimin e njoftimit të vendimit u takon autoriteteve gjyqësore, veçanërisht Gjykatës së Lartë.*
Fjalë kyçe - akses në Gjykatën Kushtetuese, neni 6 § 1 KEDNJ, afati katër mujor, njoftimi i vendimit, barra e provës


Ilia v. Albania, application no. 22824/20, judgment of 15 July 2025

Time limit for lodging a constitutional appeal: responsibility for ensuring and proving notification

Legal principle(s): 1. *The right of effective access to the Constitutional Court is impaired where the time limit for lodging a constitutional appeal is calculated from the date on which the Supreme Court's decision was delivered, rather than from the date on which the party was effectively notified of that decision, in the absence of clear and verifiable evidence establishing the date of notification.* 2. *The responsibility for recording and proving the notification of the decision lies with the judicial authorities, particularly the Supreme Court.*

Keywords: access to the Constitutional Court; Article 6 § 1 of the ECHR; four-month time limit; notification of the judicial decision; burden of proof

Përmbledhje - Çështja ka të bëjë me një mosmarrëveshje pune në të cilën kërkuesi kundërshtoi ndërprerjen e marrëdhënies së tij të punës me Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Pas rrëzimit të padisë në dy shkallët e para të gjykit, ai paraqiti rekurs në Gjykatën e Lartë në vitin 2014. Në vitin 2017, Gjykata e Lartë rrëzoi rekursin e tij në dhomë këshillimi. Kërkuesi pretendoi se kishte marrë dijeni për vendimin vetëm më 9 maj 2018, datë në të cilën vendimi mbante vulën se ishte “tërhequr” prej tij. Ai depozitoi ankim kushtetues më 6 shtator 2018, brenda afatit katërmujor të llogaritur nga data e marrjes dijeni. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese e rrëzoi ankimin si të paraqitur jashtë afatit, duke e llogaritur afatin nga data e dhënies së vendimit të Gjykatës së Lartë dhe jo nga data e njoftimit të tij. Ajo arsyetoi se vula e vendosur mbi vendim nuk provonte domosdoshmërisht datën e parë të njoftimit të kërkuetit. GJEDNJ konstatoi se kërkuesi kishte paraqitur ankimin kushtetues brenda afatit katërmujor nga momenti kur kishte marrë dijeni për vendimin e Gjykatës së Lartë. Gjykata vlerësoi se Gjykata Kushtetuese nuk kishte sqaruar se si një palë mund të provonte datën e parë të njoftimit dhe se barra e provës nuk mund t'i ngarkohej vetëm kërkuetit. Gjykata Evropiane theksoi se ishte kryesisht përgjegjësi e Gjykatës së Lartë të siguronte prova të qarta në dosje lidhur me datën e njoftimit të vendimit ndaj palëve. Në këto kushte, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me të drejtën e aksesit në Gjykatën Kushtetuese.



**10. Kotherja kundër Shqipërisë,
kërkesa nr. 51135/22,
vendim i datës 2 tetor 2025**

Siguria juridike: zbatim i menjëhershëm i rregullave të reja procedurale për çështjet në shqyrtim

Maksima - Zbatimi i menjëhershëm i ndryshimeve të ligjit procedural nuk cenon sigurinë juridike, për sa kohë që thelbi i të drejtës mbetet i garantuar.

Fjalë kyçe – ligj procedural, ndryshim, zbatim i menjëhershëm, pa-pranueshmëri rekursi, kalim në seancë, siguri juridike

Kotherja v. Albania, application no. 51135/22, judgment of 2 October 2025***Legal certainty: immediate application of new procedural rules to pending cases***

Legal principle(s): *The immediate application of amendments to procedural law does not undermine legal certainty, provided that the essence of the right remains guaranteed.*

Keywords: *procedural law, amendments, immediate application; inadmissibility of an appeal on points of law; referral to a hearing; legal certainty*

Përmbledhje - Çështja ka të bëjë me një mosmarrëveshje pronësie ndërmjet kërkueses dhe palëve të treta private. Pasi padia e saj u rrëzua nga gjykatat e faktit, kërkuesja paraqiti rekurs në Gjykatën e Lartë. Në vitin 2016, Gjykata e Lartë, në dhomë këshillimi, e deklaroi rekursin të pranueshëm dhe vendosi kalimin e çështjes për seancë gjyqësore. Ndërkohë, në vitin 2021 hynë në fuqi ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile, të cilat i dhanë kompetencë Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë që në dhomë këshillimi jo vetëm të vendoste mbi pranueshmërinë e rekursit, por edhe të shqyrtonte çështjen në themel mbi bazën e akteve të dosjes. Më 7 mars 2022, Gjykata e Lartë revokoi vendimin e saj të mëparshëm për zhvillimin e seancës dhe po në dhomë këshillimi, deklaroi rekursin të papranueshëm sipas nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile. Në arsyetimin e saj, Gjykata e Lartë analizoi pretendimet juridike të kërkueses dhe vlerësoi se gjykatat më të ulëta kishin zbatuar saktë ligjin material dhe procedural, si dhe kishin trajtuar në mënyrë të plotë pretendimet e palëve. Përpara GJEDNJ-së, kërkuesja pretendoi cenimin e parimit të sigurisë juridike, duke argumentuar se i njëjti rekurs ishte deklaruar fillimisht i pranueshëm dhe më pas i papranueshëm. GJEDNJ vlerësoi se zbatimi i menjëhershëm i rregullave të reja procedurale për çështjet në shqyrtim nuk binte ndesh me nenin 6 § 1 të Konventës. Gjykata theksoi gjithashtu se, megjithëse formalisht rekursi ishte deklaruar i papranueshëm, në realitet Gjykata e Lartë kishte shqyrtuar në themel pretendimet juridike të kërkueses dhe kishte dhënë arsyetim të mjaftueshëm mbi to. Për këtë arsye, GJEDNJ arriti në përfundimin se nuk kishte asnjë dukje shkeljeje të nenit 6 § 1 të Konventës dhe e deklaroi kërkesën haptazi të pabazuar.



11. Rarani dhe të tjerë kundër Shqipërisë - kërkesa nr. 19017/18, vendim i datës 14 tetor 2025

Kuptimi i “Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji”: arsyetimi mbi rivlerësimin e provave

Maksima – Ndërhyrja e Gjykatës së Lartë në vlerësimin e fakteve të konstatuara nga gjykatat më të ulëta duhet të shoqërohet me arsyetim të plotë dhe të bazuar në prova përndryshe, mungesa e një arsyetimi të tillë cenon standardet e procesit të rregullt ligjor.

Fjalë kyçe - vendim arbitrar, gjykim fakti, gjykatë ligji, proces i rregullt ligjor

Rarani and Others v. Albania - application no. 19017/18, judgment of 14 October 2025

Definition of the “Supreme Court as a court of law”: reasoning on the reassessment of evidence

Legal principle(s): The intervention of the Supreme Court in the assessment of facts established by lower courts must be accompanied by full and evidence-based reasoning; otherwise, the lack of such reasoning undermines the standards of due process.

Keywords: arbitrary decision, trial of fact, court of law, due process

Përmbledhje - Çështja ka të bëjë me një mosmarrëveshje pronësie mbi një parcelë prej 1,244 m² në Tiranë, e pretenduar nga kërkuessit si pjesë e një prone të blerë nga paraardhësit e tyre në vitin 1933 dhe të shtetëzuar gjatë regjimit komunist. Në vitet 1994–1997, organet administrative dhe gjyqësore njohën pjesërisht të drejtat e pronësisë së kërkuessve, por refuzuan kthimin e parcelës së mbetur për shkak të mbivendosjes me një pronë të kthyer një familjeje tjetër. Në proceset gjyqësore të nisura në vitin 2008, Gjykata e Rrethit dhe më pas Gjykata e Apelit pranuan, mbi bazën e ekspertimit dhe dokumentacionit kadastral, se paraardhësit e kërkuessve kishin pasur të drejta pronësie mbi parcelën prej 1,244 m² në momentin e shtetëzimit. Megjithatë, në vitin 2017, Gjykata e Lartë prishi vendimin e Gjykatës së Apelit dhe rrëzoi si padinë ashtu edhe kundërpadinë, duke

arsyetuar se kërkuesve u ishte kthyer tashmë më shumë pronë sesa ajo që zotëronin para shtetëzimit dhe se një pjesë e parcelës ishte shitur më herët nga paraardhësit e tyre. GJEDNJ konstatoi se Gjykata e Lartë kishte dalë në përfundime faktike të ndryshme nga ato të gjykatave të faktit, pa iu referuar ndonjë prove konkrete dhe pa shpjeguar pse kishte hedhur poshtë raportin e ekspertit dhe gjetjet e gjykatave më të ulëta. Ajo theksoi se pretendimi për shitjen e pjesshme të pronës nuk mbështetej në dokumente apo prova të administruara në proces dhe se Gjykata e Lartë kishte rivlerësuar faktet, ndonëse roli i saj në sistemin shqiptar është kryesisht ai i një gjykate ligji. Në përfundim GJEDNJ konstatoi se vlerësimi i elementeve tërësisht të paadresuara nga vendimet e gjykatave të faktit përbën një përmbyasje arbitrare të gjetjeve faktike të gjykatave më të ulëta, dhe si pasojë konstatoi shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.



**12. Lasku dhe të tjerë kundër Shqipërisë,
kërkesa nr. 6045/14,
vendim i datës 18 nëntor 2025**

Siguria juridike: shfuqizimi *proprio motu* i vendimeve përfundimtare të KKKP

Maksima - 1. Shfuqizimi *proprio motu* i vendimeve përfundimtare të KKKP, pa një afat kohor dhe pa rrethana të jashtëzakonshme apo bindëse cenon parimin e sigurisë juridike. 2. Vendimet përfundimtare të komisionit të regjistruara në ZVRPP krijojnë një “pronë” të mbrojtur në kuptim të Konventës.

Fjalë kyçe - shfuqizim vendimi përfundimtar, afat, rrethana të jashtëzakonshme, siguri juridike.

Lasku and Others v. Albania, application no. 6045/14, judgment of 18 November 2025

Legal certainty: proprio motu annulment of final KKKP decisions

Legal principle(s): 1. The *proprio motu* quashing of final KKKP (Commission on Restitution and Compensation of Property) decisions, without any applicable time limit and in the absence of exceptional or compelling circumstances, undermines the principle

of legal certainty. 2. Final decisions of the Commission that have been registered with the ZVRPP constitute a “possession” protected under the Convention.

Keywords: *quashing of a final decision, time limit, exceptional circumstances, legal certainty*

Përmbledhje - Në këtë çështje GJEDNJ konstatoi se autoritetet shqiptare kishin cenuar parimin e sigurisë juridike të garantuar nga neni 6 § 1 i Konventës, duke shfuqizuar rreth një dekadë më vonë vendimet përfundimtare të viteve 1996–1997 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Shfuqizimi u bë nga Agjencia, *proprio motu* dhe pa afat kohor, mbi një bazë të përgjithshme ligjore dhe pa rrethana të jashtëzakonshme apo bindëse që mund të justifikonin devijimin nga finaliteti i vendimeve. Gjykatat vendase përfshirë dhe Gjykatën e Lartë, pranuan këtë ndërhyrje pa dhënë arsye të mjaftueshme, veçanërisht sa i përket zbatimit të VKM nr. 528/1996, e cila lidhej me zona turistike ndërkohë që parcela në fjalë nuk ishte e tillë. Kjo situatë krijoi pasiguri juridike, duke lënë në fuqi vetëm njohjen e titullit të trashëgimisë, ndërsa kthimi në natyrë u hoq dhe një pjesë e pronës iu kalua palëve të treta.

Në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1, gjykata vlerësoi se vendimet e komisionit dhe regjistrimi në ZVRPP u kishin dhënë aplikantëve një “pronë” të mbrojtur në kuptimin e Konventës. Shfuqizimi i këtyre vendimeve përbënte ndërhyrje në këtë pronë, ndërhyrje e cila nuk ishte as e ligjshme në kuptimin konvencional, as proporcionale, pasi u bë në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike dhe pa mundësi reale për aplikantët për të ushtruar ose rivendosur të drejtën e tyre. Duke mos paraqitur rrethana të jashtëzakonshme dhe bindëse që të justifikonin këtë ndërhyrje, shteti kishte shkelur detyrimet e tij sipas Konventës. Për këtë arsye, gjykata konstatoi shkelje si të nenit 6 § 1, ashtu edhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1, dhe i kërkoi shtetit të sigurojë rikthimin e pronës ose kompensim të barasvlershëm.



13. Buzalli kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 385/22, vendim i datës 9 dhjetor 2025

Vendim papranueshmërie: shterim i mjeteve të brendshme

Maksima – Nuk mund të trajtohet në GJEDNJ pretendimi për cenimin e afatit të arsyeshëm kur një kërkesë e tillë nuk është paraqitur fillimisht para gjykatave vendase kompetente, përfshirë dhe Gjykatën Kushtetuese.
Fjalë kyçe – cenim i afatit të arsyeshëm, shterim i mjeteve të brendshme, ankim në Gjykatën Kushtetuese.

Buzalli v. Albania, application No. 385/22, judgment of 9 December 2025

Inadmissibility decision: exhaustion of domestic remedies

Legal principle(s): A complaint concerning a breach of the reasonable-time requirement cannot be examined by the ECtHR where such a complaint has not first been raised before the competent domestic courts, including the Constitutional Court..

Keywords: violation of the reasonable-time requirement, exhaustion of domestic remedies, Constitutional Court complaint

Përmbledhje - Kërkesja u dënua për vrasje në vitin 2017 dhe ankimoi vendimin në Gjykatën e Lartë. Në shtator 2021, avokati i saj paraqiti në Gjykatën e Lartë një kërkesë për përshpejtimin e procedurës së rekursit, e cila u regjistrua, por në mungesë të parashtimeve të posaçme mbi arsyet e përshpejtimit nuk u trajtua si e tillë. Në shkurt 2023, Gjykata e Lartë rrëzoi rekursin e paditëses. GJEDNJ konstatoi se, edhe pse kërkesa për përshpejtim ishte depozituar dhe nuk ishte shqyrtuar nga Gjykata e Lartë brenda afatit ligjor, paditësja nuk kishte shteruar mjetet juridike vendase. Ajo duhej t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese për t'u ankuar për mosveprimin e Gjykatës së Lartë dhe për shkeljen e afatit të arsyeshëm. Për rrjedhojë, ankesa u shpall e papranueshme për moshterim të mjeteve juridike vendase, në bazë të nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

Për vitin 2024



14. Vjola SH.P.K. kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 18076/12, vendim i datës 30 janar 2024

Tejzgjatje e afatit të shqyrtimit të çështjeve-përfshirë kërkesat për masa të përkohshme

Maksima – 1. Në mosmarrëveshjet që lidhen me cenimin e posedimit dhe ku natyra e çështjes kërkon reagim të shpejtë gjyqësor, mosveprimi procedural i gjykatave, përfshirë mungesën e shqyrtimit të kërkesave urgjente dhe periudhat e gjata të pasivitetit procedural, kontribuon në konstatimin e shkeljes së nenit 6 § 1 për tejzgjatje të procedurave. 2. E drejta e aksesit në gjykatë nuk cenohet kur pala disponon mjete të tjera juridike efektive për mbrojtjen e interesave të saj pasurore, përfshirë padinë për dëmshpërblim kontraktor

Fjalë kyçe - cenim posedimi, tejzgjatja e procedurave, afati i arsyeshëm, neni 6 § 1 KEDNJ, pasivitet procedural, masë e përkohshme, kërkesë urgjente

Vjola SH.P.K. v. Albania, application No. 18076/12, judgment of 30 January 2024


Excessive length of proceedings, including requests for interim measures

Legal principle(s): 1. In disputes concerning interference with possession, where the nature of the case requires a prompt judicial response, procedural inactivity on the part of the courts, including the failure to examine urgent applications and prolonged periods of procedural inactivity contributes to a finding of a violation of

Article 6 § 1 of the Convention on account of the excessive length of the proceedings. 2. The right of access to a court is not violated where the party has other effective legal remedies available to protect its property interests, including an action for contractual damages.

Keywords: *interference with possession, excessive length of proceedings, reasonable time, Article 6 § 1 of the ECHR, procedural inactivity, interim measure, urgent application*

Përmbledhje - Çështja ka të bëjë me tejzgjatjen e një procesi civil mbi cenimin e posedimit të dy parcelave pyjore të marra me qira nga shoqëritë kërkuese për një periudhë 25-vjeçare. Në vitin 2004, shteti ia dha me qira të njëjtën sipërfaqe edhe një pale të tretë për ndërtimin e një fshati turistik, e cila më pas hyri në parcelë dhe filloi ndërtimet. Shoqëritë kërkuese ngritën padi civile për pushimin e cenimit të posedimit, kthimin e tokës në gjendjen e mëparshme, pezullimin e punimeve dhe dëmshpërblim. Megjithatë, Gjykata e Rrethit nuk shqyrtoi asnjëherë kërkesën për masë të përkohshme. Ndërkohë, gjatë kohës që procedurat vazhdonin, ndërtimi i fshatit turistik përfundoi. Në fund, gjykatat shqiptare rrëzuan padinë me arsyetimin se, pasi ndërtimi kishte përfunduar, kërkuesit nuk mund të mbështeteshin më në padinë për pushimin e cenimit të posedimit sipas nenit 312 të Kodit Civil dhe se duhej të kishin paraqitur një padi tjetër për zhveshje nga posedimi, afati gjashtëmujor i së cilës kishte kaluar. Gjykata e Lartë la në fuqi këtë qëndrim dhe pranoi se autoritetet shtetërore kishin shkelur në mënyrë të njëanshme kontratat e qirasë të lidhura me shoqëritë kërkuese. GJEDNJ konstatoi se procedurat kishin zgjatur më shumë se shtatë vjet, përfshirë rreth tre vjet para Gjykatës së Lartë, në një mosmarrëveshje që për nga natyra kërkonte trajtim të shpejtë. Gjykata theksoi veçanërisht se Gjykata e Rrethit nuk kishte shqyrtuar kërkesën për masë të përkohshme dhe Gjykata e Lartë kishte lejuar kalimin e një periudhe të gjatë pa asnjë veprim procedural ndërmjet depozitimit të rekursit dhe marrjes së vendimit. Për këto arsye, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës vetëm për shkak të tejzgjatjes së procedurave. Ndërkohë, pretendimet për cenim të aksesit në gjykatë dhe të drejtës së pronës u deklaruan haptazi të pabazuara, pasi Gjykata vlerësoi se shoqëritë kishin mjete të tjera juridike efektive, veçanërisht padi për dëmshpërblim ndaj organeve shtetërore për shkeljen e kontratave të qirasë.



**15. Rexhepi SH.P.K kundër Shqipërisë,
kërkesa nr. 44789/07,
vendim i datës 13 shkurt 2024**

Shterimi i mjeteve juridike të brendshme-akses efektiv në gjykatë

Maksima – 1. Lejet e planifikimit dhe të ndërtimit mund të përbëjnë “pasuri” në kuptim të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës. 2. Ankuesi nuk shteron mjetet juridike të brendshme kur nuk kundërshton drejtpërdrejt aktin administrativ që përbën burimin kryesor të pretenduar të cenimit të së drejtës së tij. 3. E drejta e aksesit në gjykatë nuk cenohet kur gjykatat vendase shqyrtojnë pretendimet e palës dhe zbatojnë në mënyrë të arsyeshme kërkesat procedurale mbi afatet dhe legjitimitetin aktiv. 4. Rrëzimi de plano i rekursit nga Gjykata e Lartë, pa arsyetim të zgjeruar, nuk përbën në vetvete shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

Fjalë kyçe – leje ndërtimi, leje planifikimi, e drejta e pronës, neni 1 i Protokollit nr. 1 KEDNJ, neni 6 § 1 KEDNJ, akses në gjykatë, shterimi i mjeteve juridike, legjitimiteti aktiv, afati procedural, akt administrative, rrëzim rekursi de plano, arsyetim gjyqësor, proces i rregullt ligjor

**Rexhepi SH.P.K. v. Albania, application no. 44789/07,
judgment of 13 February 2024**

Exhaustion of domestic remedies- effective access to a court

Legal principle(s): 1. Planning and building permits may constitute “possessions” within the meaning of Article 1 of Protocol No. 1 to the Convention. 2. An applicant has not exhausted domestic remedies where it has failed to challenge directly the administrative act constituting the principal alleged source of interference with its rights. 3. The right of access to a court is not violated where the domestic courts examine the party’s claims and reasonably apply the procedural requirements concerning time limits and legal standing. 4. The de plano dismissal by the Supreme Court of an appeal on points of law, without extensive reasoning, does not in itself constitute a violation of Article 6 § 1 of the Convention.

Keywords: building permit, planning permit, right to property, Article 1 of Protocol No. 1 to the ECHR, Article 6 § 1 of the ECHR, access to a court, exhaustion of domestic remedies, legal standing,

procedural time limit, administrative act, de plano dismissal of an appeal on points of law, judicial reasoning, fair trial

Përmbledhje – Çështja ka të bëjë me anulimin e lejeve të ndërtimit të një shoqërie ndërtimi në Tiranë dhe me konfliktin administrativ e gjyqësor të krijuar pas dhënies së lejeve të mbivendosura për të njëjtën sipërfaqe toke. Shoqëria kërkuese kishte lidhur një kontratë sipërmarrjeje me pronarët fillestarë të truallit dhe kishte marrë leje planifikimi dhe ndërtimi nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Bashkisë Tiranë në vitet 1997–2000. Më pas, një shoqëri tjetër “X” lidhi marrëveshje me persona të tjerë që pretendonin pronësinë mbi të njëjtin truall dhe mori gjithashtu leje ndërtimi nga autoritetet vendore. Shoqëria kërkuese ngriti padi për anulimin e lejeve të dhëna shoqërisë tjetër. Ndërkohë, në vitin 2004, Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit anuloi lejet e vetë shoqërisë kërkuese, duke vlerësuar se zgjatja e vlefshmërisë së tyre kishte qenë e paligjshme. Gjykata e Rrethit Tiranë fillimisht i dha të drejtë shoqërisë kërkuese dhe anuloi lejet e kompanisë tjetër, duke konsideruar absolutisht të pavlefshëm vendimin e Këshillit Kombëtar që kishte anuluar lejet e saj. Megjithatë, Gjykata e Apelit ndryshoi vendimin dhe rrëzoi padinë, duke arsyetuar se kërkesa ishte paraqitur jashtë afatit 30-ditor për kundërshtimin e akteve administrative, shoqëria nuk kishte më legjitimitet aktiv pasi lejet e saj ishin anuluar dhe çdo pretendim kundër vendimit të Këshillit Kombëtar duhej të ndiqej në një procedim të veçantë gjyqësor. Gjykata e Lartë shpalli të papranueshëm rekursin *de plano*, ndërsa Gjykata Kushtetuese konstatoi se nuk kishte shkelje të së drejtës për proces të rregullt ligjor. Në GJEDNJ, shoqëria pretendoi shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 dhe nenit 6 § 1 të Konventës, duke argumentuar se anulimi i lejeve kishte cenuar të drejtën e saj të pronës, gjykatat kishin vepruar në mënyrë arbitrare dhe Gjykata e Apelit kishte cenuar aksesin në gjykatë. GJEDNJ pranoi se lejet e planifikimit dhe ndërtimit përbënin “pasuri” në kuptim të nenit 1 të Protokollit nr. 1. Megjithatë, ajo konstatoi se shoqëria nuk kishte shteruar mjetet juridike të brendshme, pasi nuk kishte ngritur një padi të veçantë kundër vendimit të Këshillit Kombëtar që anuloi lejet e saj. Për këtë arsye, ankimi mbi të drejtën e pronës u shpall i papranueshëm. Lidhur me nenin 6 § 1, GJEDNJ vlerësoi se shoqëria kishte pasur akses efektiv në gjykatë, gjykatat vendase kishin dhënë arsyetim jo arbitrar dhe vendimi i Gjykatës së Lartë për të rrëzuar rekursin pa arsyetim të zgjeruar nuk binte ndesh me Konventën.



**16. Leka kundër Shqipërisë,
kërkesa nr. 60569/09,
vendim i datës 5 mars 2024**

Parashikueshmëria e akuzës dhe ricilësimi juridik i saj

Maksima - 1. Ricilësimi juridik i veprës penale nga gjykata e apelit nuk çënon nenin 6 të Konventës kur ai bazohet në të njëjtat fakte materiale dhe është objektivisht i parashikueshëm për mbrojtjen. 2. E drejta për avokat gjatë hetimit paraprak është një garanci themelore e procesit të rregullt, por mungesa e avokatit në fazat fillestare nuk sjell automatikisht shkelje të nenit 6 nëse tërësia e procesit mbetet e garantuar. 3. Vlerësimi i procesit të drejtë penal duhet të bëhet në mënyrë tërësore, duke analizuar jo vetëm një provë ose një fazë procedurale, por të gjithë procedimin në tërësi.

Fjalë kyçe – ricilësim juridik i akuzës, neni 6 KEDNJ, parashikueshmëria e akuzës, standardi i procesit të drejtë, proces i rregullt ligjor, e drejta për mbrojtje, marrje në pyetje pa avokat, proces i rregullt ligjor

Leka v. Albania, application no. 60569/09, judgment of 5 March 2024

Foreseeability of the charge and its legal reclassification

Legal principle(s): 1. The legal reclassification of a criminal offence by the court of appeal does not violate Article 6 of the Convention where it is based on the same material facts and was objectively foreseeable by the defense. 2. The right to legal assistance during the preliminary investigation is a fundamental safeguard for a fair trial. However, the absence of a lawyer during the initial stages of the proceedings does not automatically result in a violation of Article 6 where the fairness of the proceedings as a whole has been preserved. 3. The fairness of criminal proceedings must be assessed as a whole, considering not merely a single item of evidence or an individual procedural stage, but the proceedings in their entirety.

Keywords: legal reclassification of the charge, Article 6 of the ECHR, foreseeability of the charge, fair-trial standard, fair legal process, rights of the defense, questioning without a lawyer, overall fairness of the proceedings

Përmbledhje – Çështja ka të bëjë me procesin e drejtë penal ndaj kërkuesit, i cili ishte dënuar me burgim të përjetshëm për vjedhje me pasojë vdekjen, vrasje të mbetur në tentativë dhe armëmbajtje pa leje, në lidhje me vrasjen e një kambisti valutor në Sarandë në vitin 2005. Sipas akuzës, kërkuesi kishte mashtruar viktimën duke pretenduar se dëshironte të këmbente 8 000 euro, ndërkohë që qëllimi i tij real ishte t'i merrte paratë pa kryer shkëmbimin. Ai e kishte tërhequr viktimën dhe vëllain e saj në një zonë të izoluar në Shijan, ku kishte qëlluar për vdekje njërin dhe kishte tentuar të vriste tjetrin. Gjatë hetimit, kërkuesi u mor disa herë në pyetje nga prokuroria pa praninë e një avokati. Edhe pse ishte informuar formalisht për të drejtën për mbrojtje, ai deklaroi se do të vendoste më vonë nëse do të kishte avokat dhe dha deklarime vetë-inkrimnuese. Një tjetër element i rëndësishëm ishte paraqitja për njohje. Kërkuesi pretendoi se procedura ishte kryer në mënyrë të parregullt, pasi ai ishte dallueshëm nga personat e tjerë të paraqitur dhe nuk kishte pasur avokat gjatë këtij veprimi procedural. Gjykata e shkallës së parë e shpalli fajtor për vrasje në rrethana cilësuese dhe tentativë vrasjeje, duke u mbështetur ndër të tjera në rrëfimin e kërkuesit në prokurori, përgjimet ambientale, dëshmitë e dëshmitarëve, ekspertimin balistik dhe paraqitjen për njohje. Në apel, Gjykata e Apelit Gjirokastër ndryshoi cilësimin juridik të fakteve pa ndryshuar bazën faktike të çështjes. Ajo arriti në përfundimin se ngjarja nuk përbënte “vrasje në rrethana cilësuese”, por “vjedhje me pasojë vdekjen” dhe “vrasje të mbetur në tentativë në lidhje me një krim tjetër”, duke lënë në fuqi dënimin me burgim të përjetshëm.

Kërkuesi pretendoi përpara GJEDNJ-së ricilësimi juridik kishte cenuar të drejtën e tij për t'u informuar mbi natyrën e akuzës dhe për të përgatitur mbrojtjen, mungesa e avokatit gjatë hetimit kishte cenuar procesin e rregullt dhe paraqitja (parada) për njohje ishte kryer në kundërshtim me standardet e nenit 6 të Konventës. GJEDNJ konstatoi se nuk kishte shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 të Konventës. Gjykata vlerësoi se ricilësimi juridik nga Gjykata e Apelit ishte bazuar në të njëjtat fakte materiale dhe ishte i parashikueshëm për mbrojtjen, kërkuesi dhe avokati i tij kishin pasur mundësi reale për të diskutuar një cilësim alternativ gjatë apelimit, mungesa e avokatit në fazën fillestare nuk kishte cenuar në mënyrë të parikuperueshme drejtësinë e procesit në tërësi dhe prova të tjera të rëndësishme mbështesnin fajësinë e kërkuesit përtej deklarimeve të tij fillestare. Gjykata vlerësoi gjithashtu se, ndonëse kishte mangësi në mënyrën e kryerjes së paraqitjes (paradës) për njohje, këto mangësi nuk ishin të tilla që të komprometonin tërësinë e procesit penal. Për sa i përket Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, GJEDNJ evidentoi se të dyja

kishin trajtuar çështjen e ricilësimit juridik dhe të drejtës së mbrojtjes, duke konsideruar se ndryshimi i cilësimit juridik nuk kishte ndryshuar faktet materiale të akuzës dhe nuk kishte sjellë cenim të së drejtës për mbrojtje.



**17. Iliria S.R.L. kundër Shqipërisë,
kërkesa nr. 31011/09,
vendim i datës 5 mars 2024**

Afati i arsyeshëm në procedurat për njohje vendimi arbitrazhi ndërkombëtar

Maksima: 1. Procedurat për njohjen e një vendimi arbitrazhi ndërkombëtar duhet të zhvillohen brenda një afati të arsyeshëm; zgjatja e tyre për shumë vite cenon nenin 6 § 1 të Konventës, edhe kur çështja paraqet kompleksitet juridik. 2. Kthimet e përsëritura për rigjykim dhe mungesa e një zgjidhjeje përfundimtare nga gjykatat e larta përbëjnë faktorë relevantë në vlerësimin e tejzgjatjes së procedurave gjyqësore.

Fjalë kyçe: njohje e vendimeve të huaja, arbitrazh, afat i arsyeshëm, neni 6 § 1 KEDNJ, kthim për rigjykim, zgjidhje përfundimtare.

Iliria S.R.L. v. Albania, application no. 31011/09, judgment of 5 March 2024

Reasonable-time requirement in proceedings for the recognition of an international arbitral award

Legal principle(s): 1. Proceedings concerning the recognition of an international arbitral award must be conducted within a reasonable time. Proceedings lasting several years may violate Article 6 § 1 of the Convention, even where the case involves a degree of legal complexity. 2. Repeated remittals for fresh examination and the failure of the higher courts to provide a final resolution are relevant factors in assessing whether judicial proceedings have been excessively prolonged.

Keywords: recognition of foreign decisions, arbitration, reasonable time, Article 6 § 1 of the ECHR, return for retrial, final resolution

Përmbledhje - Çështja ka të bëjë me refuzimin e autoriteteve shqiptare për të njohur dhe ekzekutuar një vendim arbitrazhi ndërkombëtar të vitit 1993, i cili kishte detyruar shtetin shqiptar t'i paguante shoqërisë italiane ILIRIA s.r.l. një shumë të konsiderueshme dëmshpërblimi në lidhje me një projekt investimi turistik në plazhin e Durrësit. Marrëveshja e vitit 1991 ndërmjet shoqërisë kërkuese dhe autoriteteve shqiptare parashikonte arbitrazh ndërkombëtar dhe zbatim të ligjit zviceran për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Tribunali arbitrazhit konstatoi se autoritetet shqiptare kishin penguar realizimin e investimit duke ndryshuar kufijtë administrativë të zonës dhe duke transferuar pjesë të truallit tek palë të treta. Për këtë arsye, arbitrazhi vendosi në favor të shoqërisë kërkuese. Shoqëria kërkuese paraqiti kërkesën për njohjen e vendimit arbitral në vitin 1998 dhe fillimisht Gjykata e Apelit Tiranë e njohu atë, duke lëshuar edhe urdhër ekzekutimi. Megjithatë, pas rivendosjes në afat të Qeverisë, procedurat u rihapën dhe vijuan për shumë vite në të gjitha nivelet e juridiksionit, përfshirë Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese. Procedurat përfunduan vetëm në vitin 2015 me refuzimin përfundimtar të njohjes së vendimit arbitral. Gjykatat vendase refuzuan përfundimisht njohjen e vendimit arbitral, duke arsyetuar se ai binte ndesh me “parimet bazë të ligjit shqiptar”, pasi në kohën e lidhjes së marrëveshjes legjislacioni shqiptar nuk lejonte arbitrazh ndërkombëtar kundër shtetit në mungesë të një traktati ndërkombëtar të ratifikuar. Shoqëria kërkuese pretendoi shkelje të nenit 6 § 1 dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 për shkak të mosnjohjes dhe mosekzekutimit të vendimit arbitral. Gjykata Evropiane pranoi se vendimi arbitral krijonte të paktën një “pritshmëri legjitime” të mbrojtur si “pasuri”. Megjithatë, ajo vlerësoi se refuzimi i gjykatave shqiptare për njohjen e vendimit nuk ishte arbitrar apo haptazi i paligjshëm. GJEDNJ theksoi se gjykatat shqiptare kishin interpretuar në mënyrë të arsyeshme legjislacionin e kohës së regjimit socialist, sipas të cilit arbitrazhi ndërkombëtar kundër shtetit shqiptar ishte i mundur vetëm nëse mbështetej në një marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar. Në lidhje me kohëzgjatjen GJEDNJ vlerësoi se procedurat për njohjen e vendimit arbitral kishin zgjatur rreth shtatëmbëdhjetë vite për tre nivele juridiksioni, një kohëzgjatje që tejkalonte qartësisht standardin e “afatit të arsyeshëm” sipas nenit 6 § 1 të Konventës. Gjykata theksoi se çështja kishte njëfarë kompleksiteti juridik, por kjo nuk justifikonte zgjatjen ekstreme të procedurave. Për këto arsye, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës vetëm për shkak të tejzgjatjes së procedurave për njohjen e vendimit arbitral.



**18. Biba kundër Shqipërisë,
kërkesa nr. 24228/18,
vendim i datës 7 maj 2024**

Mbrojtja efektive e integritetit fizik të fëmijëve në institucionet arsimore

Maksima – 1. *E drejta e aksesit në gjykatë cenohet kur afati për paraqitjen e ankimit kushtetues llogaritet nga data e dhënies së vendimit dhe jo nga data kur pala merr dijeni efektive për përmbajtjen dhe arsyetimin e tij.* 2. *Mbrojtja efektive e integritetit fizik të fëmijëve kërkon që gjykatat të trajtojnë në mënyrë reale dhe substanciale pretendimet mbi dështimin e institucioneve arsimore për të parandaluar rreziqe të parashikueshme.*

Fjalë kyçe – aksesit në gjykatë, afat ankimi kushtetues, marrja dijeni efektivisht, mbrojtje efektive e fëmijëve, trajtim substancial i pretendimeve, detyrime pozitive të shtetit, neni 8 KEDNJ

Biba v. Albania, application no. 24228/18, judgment of 7 May 2024

Effective protection of children's physical integrity in educational institutions

Legal principle(s): 1. *The right of access to a court is impaired where the time limit for lodging a constitutional complaint is calculated from the date on which the decision was delivered, rather than from the date on which the party effectively became aware of its content and reasoning.* 2. *The effective protection of children's physical integrity requires the courts to examine, genuinely and substantively, allegations concerning the failure of educational institutions to prevent foreseeable risks.*

Keywords: *access to a court, time limit for lodging a constitutional complaint, effective knowledge of the decision, effective protection of children, substantive examination of claims, positive obligations of the State, Article 8 of the ECHR,*

Përmbledhje - Çështja ka të bëjë me dëmtimin e rëndë fizik të djalit të mitur të kërkuarit, i cili humbi 90% të shikimit në njërin sy pasi u godit me një objekt të lëshuar nga katapultë llastiku nga një nxënës tjetër në

ambientet e një shkolle private në Tiranë gjatë pushimit mes orëve të mësimi. Kërkuesi ngriti padi civile kundër shkollës, duke pretenduar se ajo kishte dështuar të garantonte sigurinë e nxënësve, të kontrollonte përdorimin e katapultave në ambientet e shkollës dhe të siguronte reagim të menjëhershëm pas incidentit. Ai argumentoi se katapultat ishin përdorur prej ditësh nga nxënësit pa asnjë ndërhyrje nga stafi i shkollës. Gjykatat shqiptare rrëzuan padinë, duke arsyetuar se dëmi ishte shkaktuar nga një nxënës tjetër dhe se mungonte lidhja shkakësore ndërmjet veprimeve ose mosveprimeve të shkollës dhe dëmit të pësuar. Ato vlerësuan se shkolla nuk mund ta kishte parashikuar incidentin dhe se kërkuesi mund të kërkonte dëmshpërblim nga prindërit e nxënësit ose nga kompania e sigurimeve. Gjykata e Lartë rrëzoi rekursin në dhomë këshillimi, duke vlerësuar se ankimi nuk ngrinte çështje të zbatimit të gabuar të ligjit material ose procedural. Më pas, Gjykata Kushtetuese e shpalli të papranueshëm ankimin kushtetues si jashtë afatit katërmujor, duke e llogaritur afatin nga data e dhënies së vendimit të Gjykatës së Lartë dhe jo nga data kur kërkuesi kishte marrë dijeni efektive për arsyetimin e tij. GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 8 të Konventës, duke vlerësuar se gjykatat shqiptare nuk kishin trajtuar në mënyrë të përshtatshme pretendimet thelbësore të kërkuesit mbi, mungesën e mbikëqyrjes së nxënësve gjatë pushimit, tolerimin e përdorimit të sendeve të rrezikshme në ambientet e shkollës dhe reagimin e pamjaftueshëm të shkollës pas incidentit. Gjykata theksoi se institucionet arsimore kanë detyrim pozitiv për të garantuar integritetin fizik të fëmijëve gjatë kohës që ndodhen nën kujdesin e tyre dhe se shteti nuk mund të shmangë përgjegjësinë e tij duke ia deleguar funksionin edukativ subjekteve private. GJEDNJ konstatoi gjithashtu shkelje të nenit 6 § 1 për cenim të aksesit në gjykatë, pasi Gjykata Kushtetuese kishte llogaritur afatin e ankimit nga data e shpalljes së vendimit të Gjykatës së Lartë dhe jo nga data kur kërkuesi kishte marrë dijeni efektive për vendimin dhe arsyetimin e tij.



**19. Zela kundër Shqipërisë,
kërkesa nr. 33164/11,
vendim i datës 11 qershor 2024**

Ekzekutimi i një urdhri shembjeje prone, pa kompensim dhe pa garanci efektive procedurale

Maksima: 1. Shembja e një objekti dhe shfuqizimi i titullit të pronësisë, pa kompensim dhe pa garanci procedurale efektive, cenonjë ekuilibrin e drejtë ndërmjet interesit publik dhe të drejtës së pronës sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1. 2. Parimi i qeverisjes së mirë kërkon që autoritetet publike të veprojnë në mënyrë koherente, të parashikueshme dhe pa i ngarkuar individit barrën disproporcionale të gabimeve administrative të shtetit. 3. Ekzekutimi i një urdhri shembjeje pavarësisht një mase sigurimi gjyqësore dhe pa dëgjuar efektivisht personin e prekur cenon garancitë procedurale të mbrojtjes së pronës.

Fjalë kyçe: shembje objekti, shfuqizim titulli pronësie, e drejta e pronës, interes publik, neni 1 i Protokollit nr. 1 KEDNJ, mirëqeverisje, barrë disproporcionale, urdhër shembjeje, masë sigurimi, garanci procedurale, mbrojtje e pronës

Zela v. Albania, application no. 33164/11, judgment of 11 June 2024

Enforcement of a property demolition order without compensation or effective procedural safeguards

Legal principle(s): 1. The demolition of a building and the annulment of the relevant property title, without compensation or effective procedural safeguards, impairs the fair balance between the public interest and the right to property under Article 1 of Protocol No. 1 to the Convention. 2. The principle of good governance requires public authorities to act consistently and predictably and not to impose on individuals a disproportionate burden arising from the State's administrative errors. 3. The enforcement of a demolition order despite an interim judicial measure, and without effectively hearing the person concerned, violates the procedural safeguards inherent in the protection of property rights.

Keywords: demolition of a building; annulment of a property title, right to property, public interest, Article 1 of Protocol No. 1 to the ECHR, good governance, disproportionate burden; demolition order, interim measure, procedural safeguards, protection of property

Përmbledhje: Çështja ka të bëjë me shembjen e objektit të kërkuarit pranë lumit Lana në Tiranë. Kërkuari kishte ndërtuar objektin mbi bazën e një lejeje ndërtimi të lëshuar nga autoritetet shtetërore në vitin 1992 dhe e kishte regjistruar pronën në hipotekë në vitin 1997. Në vitin 2002, autoritetet urbanistike urdhëruan shembjen e objektit me arsyetimin se

ai ishte ndërtim i paligjshëm dhe pengonte projektet urbanistike të zonës. Kërkuesi kundërshtoi urdhrin e shembjes dhe siguroi një masë sigurimi nga gjykata për pezullimin e tij, por objekti u shemb megjithatë. Gjykatat e faktit refuzuan kompensimin, duke arsyetuar se kërkuesi nuk kishte provuar pronësinë mbi truallin dhe se ndërtimi nuk përmbushte kushtet ligjore të lejes së ndërtimit. Gjykata e Lartë konfirmoi qëndrimin të gjykatave më të ulëta që e trajtuan ndërtimin si të paligjshëm, pavarësisht faktit se kërkuesi kishte vepruar mbi bazën e një lejeje ndërtimi të lëshuar nga vetë autoritetet shtetërore, dhe nuk mori në konsideratë parimin e mirëbesimit dhe të qeverisjes së mirë, duke ia ngarkuar kërkuesit të gjithë barrën e pasojave të krijuara nga veprimet dhe paqartësitë administrative të shtetit. Lidhur me nenin 1 § 6 të Konventës, kërkuesi u ankua për tejzgjatjen e procedurave. GJEDNJ konstatoi se procedurat kishin zgjatur rreth tetë vjet e gjysmë në katër shkallë juridiksioni, por vlerësoi se kohëzgjatja nuk kishte kaluar kufirin e “afatit të arsyeshëm”, duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjes, numrin e vendimeve dhe faktin se vetë kërkuesi kishte kontribuar pjesërisht në zgjatjen e procedurës. Për rrjedhojë, Gjykata nuk konstatoi shkelje të nenit 6 § 1 për kohëzgjatjen e procesit. Sa i përket nenit 1 të Protokollit nr. 1, GJEDNJ konstatoi se, edhe nëse autoritetet e konsideronin ndërtimin si të paligjshëm, kërkuesi kishte marrë leje ndërtimi nga organet kompetente, kishte regjistruar pronën dhe e kishte poseduar atë për më shumë se nëntë vite. Për këtë arsye, ajo përbënte “pasuri” në kuptim të Konventës. Në përfundim GJEDNJ vlerësoi se, edhe pse ndërhyrja ndiqte një qëllim legjitim urbanistik, autoritetet shqiptare nuk kishin ruajtur ekuilibrin e drejtë ndërmjet interesit publik dhe të drejtës së pronës së kërkuesit. Gjykata theksoi se kërkuesi kishte vepruar mbi bazën e akteve të lëshuara nga vetë shteti, nuk kishte tregues keqbesimi nga ana e tij dhe nuk mund të mbante i vetëm pasojat e gabimeve ose paqartësive administrative të autoriteteve. Për këto arsye, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.



**20. Keta kundër Shqipërisë,
kërkesa nr. 9227/19,
vendim i datës 11 qershor 2024**

Arrest në flagrancë, informim/dijeni reale për arsyet e privimit nga liria

Maksima: 1. E drejta e personit të arrestuar për t'u informuar mbi arsyet e privimit nga liria respektohet kur, pavarësisht formës së përdorur nga autoritetet, ai vihet në kohë në dijeni të bazës faktike dhe juridike të arrestimit të tij. 2. Neni 5 § 4 i Konventës nuk i detyron shtetet të krijojnë një nivel të dytë juridiksioni për shqyrtimin e ligjshmërisë së paraburgimit dhe kufizimi i rekursit në Gjykatën e Lartë vetëm për shkaqe të caktuara ligjore është i pajtueshëm me Konventën. 3. Kushtet më të rrepta të pranueshmërisë për rekursin në Gjykatën e Lartë nuk cenojnë vetvetiu të drejtën për kontroll gjyqësor efektiv të paraburgimit.

Fjalë kyçe: neni 5 § 2 KEDNJ, neni 5 § 4 KEDNJ, arrest në flagrancë, informimi mbi akuzën, paraburgim, kontroll gjyqësor i paraburgimit, kufizim ligjor i rekursit, pranueshmëria e rekursit

Keta v. Albania, application no. 9227/19, judgment of 11 June 2024

Arrest in flagrante delicto: effective awareness of the reasons for deprivation of liberty

Legal principle(s): 1. The right of a detained person to be informed of the reasons for the deprivation of liberty is respected where, irrespective of the particular form used by the authorities, the person is informed promptly of the factual and legal grounds for the arrest. 2. Article 5 § 4 of the Convention does not require States to establish a second level of jurisdiction for reviewing the lawfulness of pre-trial detention. Limiting appeals on points of law before the Supreme Court to specified legal grounds is compatible with the Convention. 3. Stricter admissibility requirements governing appeals on points of law before the Supreme Court do not, themselves, undermine the right to an effective judicial review of pre-trial detention.

Keywords: Article 5 § 2 of the ECHR, Article 5 § 4 of the ECHR,

arrest in flagrante delicto, information concerning the reasons for arrest, pre-trial detention, judicial review of pre-trial detention, statutory limitations on appeals on points of law, admissibility of an appeal on points of law

Përmbledhje: Çështja ka të bëjë me ankesat e kërkuarit sipas nenit 5 § 2 dhe 4 të Konventës në lidhje me informimin mbi arsyet e arrestimit të tij dhe efektivitetin e mjeteve për të kundërshtuar paraburgimin. Kërkuari u arrestua në flagrancë në dhjetor 2018 për posedim të lëndëve narkotike, pasi policia i gjeti drogë në trup dhe më pas në banesë, ku vetë kërkuari orientoi oficerët drejt vendit ku mbante lëndën narkotike dhe një peshore. Ai u mor në pyetje në praninë e avokatit vetëm pak orë pas arrestimit, u informua për akuzat dhe të drejtat e tij dhe nënshkroi procesverbalin e arrestimit, ku përcaktohej vepra penale për të cilën dyshohej. Më pas, Gjykata e Apelit Tiranë caktoi masën “arrest në burg”, duke arsyetuar se sasia e drogës dhe rrethanat e çështjes krijojnë dyshime për shpërndarje të lëndëve narkotike dhe rrezik përsëritjeje të veprës penale. Kërkuari pretendoi para GJEDNJ-së se nuk ishte informuar menjëherë për arsyet e arrestimit dhe se Gjykata e Lartë nuk kishte garantuar një shqyrtim efektiv dhe të shpejtë të ankimit kundër paraburgimit. GJEDNJ vlerësoi se, në rrethanat konkrete, kërkuari e kuptonte qartë arsyen e arrestimit të tij që në momentin e ndalimit dhe se autoritetet e kishin informuar në mënyrë të mjaftueshme për akuzat ndaj tij. Gjykata theksoi se neni 5 § 2 nuk kërkon ndonjë formë të caktuar njoftimi, por vetëm që personi të jetë realisht në dijeni të arsyeve të privimit nga liria. Lidhur me nenin 5 § 4, GJEDNJ vlerësoi se Shqipëria nuk kishte detyrim të sigurojë një shkallë të dytë kontrolli gjyqësor mbi paraburgimin në Gjykatën e Lartë dhe se kufizimet ligjore për rekursin në këtë gjykatë ishin të lejueshme. Gjykata konstatoi se kërkuari nuk ishte mbështetur në shkaqet ligjore të rekursit sipas nenit 432 të KPP dhe se Gjykata e Apelit kishte dhënë arsye të mjaftueshme për paraburgimin. Gjithashtu, periudha prej më pak se tre muajsh për shqyrtimin e rekursit në Gjykatën e Lartë nuk u konsiderua e tepruar. Për këto arsye, GJEDNJ deklaroi kërkesën haptazi të pabazuar dhe të papranueshme.



**21. Ramaj kundër Shqipërisë,
kërkesa nr. 17758/06,
vendim i datës 10 dhjetor 2024**

E drejta e pronësisë e konfirmuar me vendim gjyqësor të formës së prerë-probleme strukturore mosregjistrim prone

Maksima: 1. Dështimi i autoriteteve shtetërore për të regjistruar dhe ekzekutuar për një kohë të gjatë një titull pronësie të konfirmuar me vendim gjyqësor të formës së prerë cenon të drejtën për gëzimin paqësor të pasurisë sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1. 2. Problemet strukturore të sistemit kadastral, titujt e mbivendosur dhe paqartësitë administrative nuk mund t'i transferohen si barrë disproporcionale pronarit që disponon një titull të vlefshëm pronësie. 3. Mosregjistrimi i një titulli pronësie nuk cenon vetvetiu vlefshmërinë e tij kur e drejta e pronësisë është njohur me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Fjalë kyçe: mosregjistrim prone, mosekzekutim i vendimit gjyqësor, titull pronësie, neni 1 i Protokollit nr. 1 KEDNJ, probleme strukturore, mbivendosje titujsh, barrë disproporcionale, titull i vlefshëm pronësie,

Ramaj v. Albania, application no. 17758/06, judgment of 10 December 2024

Property rights confirmed by a final and binding judicial decision: structural problems and failure to register property

Legal principle(s): 1. The prolonged failure of the State authorities to register and enforce a property title confirmed by a final and binding judicial decision violates the right to the peaceful enjoyment of possessions under Article 1 of Protocol No. 1 to the Convention. 2. Structural problems within the cadastral system, overlapping property titles and administrative uncertainty cannot impose a disproportionate burden on an owner holding a valid property title. 3. The failure to register a property title does not affect its validity where the right of ownership has been recognized by a final and binding judicial decision.

Keywords: failure to register property, non-enforcement of a judicial decision, property title, Article 1 of Protocol No. 1 to the

ECHR, structural problems, overlapping property titles, disproportionate burden, valid property title,

Përmbledhje: Çështja ka të bëjë me mosregjistrimin dhe mosekzekutimin për më shumë se njëzet vite të drejtës së pronësisë së kërkuesit mbi një truall prej 6,700 m² në zonën “Uji i Ftohtë”, Vlorë. Prona ishte rikthyer fillimisht në favor të babait të kërkuesit në vitin 1996 me AMTP dhe më pas e drejta e pronësisë u rikonfirmua me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit Vlorë në vitin 2004. Megjithëse kërkuesi paraqiti vazhdimisht kërkesa për regjistrimin e pronës, ZRPP-ja refuzoi ose pezulloi regjistrimin për shkak të problematikave të titujve të mbivendosur, pezullimit administrativ të regjistrimeve në zonë, mungesës së hartave të sakta kadastrale dhe ekzistencës së ndërtimeve pa leje të legalizuara në truall. Autoritetet shtetërore i kërkuan kërkuesit në mënyrë të përsëritur dokumente shtesë, edhe pse ai kishte paraqitur dokumentacionin e nevojshëm dhe vendimi gjyqësor në favor të tij ishte përfundimtar dhe i ekzekutueshëm. GJEDNJ konstatoi se, sipas ligjit shqiptar, mungesa e regjistrimit nuk cenonte vlefshmërinë e titullit të pronësisë dhe se kërkuesi kishte një “pasuri” në kuptim të nenit 1 të Protokollit nr. 1. Gjykata theksoi se autoritetet shqiptare kishin dështuar për vite të tëra të zbatonin vendimin e formës së prerë dhe të siguronin regjistrimin e pronës, duke ia transferuar kërkuesit barrën e problemeve strukturore të sistemit kadastral dhe të titujve të mbivendosur. Gjykata bëri dallim ndërmjet pjesës së truallit që nuk ishte zënë nga ndërtime pa leje, për të cilën shteti mbante përgjegjësi kryesore për mosregjistrimin dhe mosekzekutimin e titullit dhe pjesës së zënë nga ndërtime pa leje të legalizuara, ku kërkuesi nuk kishte ndërmarrë mjete juridike konkrete për të kundërshtuar pushtimin ose për të kërkuar kompensim sipas skemës ligjore ekzistuese. Për këto arsye, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 vetëm për pjesën e truallit që mbeti e paregjistruar dhe e pazbatueshme për shkak të dështimit të autoriteteve shtetërore për të garantuar ekzekutimin efektiv të titullit të pronësisë.



22. Gaba kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 33369/17, vendim i datës 17 dhjetor 2024

Siguria juridike: rishikim i vendimit të formës së prerë - res judicata

Maksima: 1. Parimi i sigurisë juridike cenohet kur një vendim i formës së prerë rishikohet dhe anulohet pa ekzistencën e rrethanave thelbësore dhe detyruese që justifikojnë ndërhyrjen në efektin res judicata. 2. Një mjet i jashtëzakonshëm rishikimi, i pakufizuar në kohë dhe në shkaqe ligjore, është i papajtueshëm me kërkesat e parashikueshmërisë procedurale dhe sigurisë juridike sipas nenit 6 § 1 të Konventës. 3. Rishqyrtimi i të njëjtave prova për të arritur në një përfundim të ndryshëm nuk mund të përdoret si mjet për të anuluar një vendim të formës së prerë.

Fjalë kyçe: siguri juridike, vendim i formës së prerë, rrethana thelbësore, res judicata, mjet rishikimi, rishikim i jashtëzakonshëm, nenit 6 § 1 KEDNJ, anulim vendimi

Gaba v. Albania, application no. 33369/17, judgment of 17 December 2024

Legal certainty: review of a final and binding judgment - res judicata

Legal principle(s): 1. The principle of legal certainty is infringed where a final and binding judgment is reviewed and annulled in the absence of substantial and compelling circumstances capable of justifying interference with its res judicata effect. 2. An extraordinary review remedy that is unlimited in time and in respect of the legal grounds on which it may be exercised is incompatible with the requirements of procedural foreseeability and legal certainty under Article 6 § 1 of the Convention. 3. The reassessment of the same evidence for the purpose of reaching a different conclusion cannot be used as a means of setting aside a final and binding judgment.

Keywords: legal certainty, final and binding judgment, substantial and compelling circumstances, res judicata, review remedy, extraordinary review, Article 6 § 1 of the ECHR, annulment of a judgment

Përmbledhje: Çështja ka të bëjë me anulimin e një vendimi të formës së prerë të Komisionit të Rikthimit dhe Kompensimit të Pronave, i cili në vitin 2006 i kishte rikthyer kërkuarit një sipërfaqe kullote prej 335 hektarësh në Lazarat, të regjistruar më pas në hipotekë në favor të tij. Vendimi ishte mbështetur në një vendim gjyqësor të vitit 2003, prova dokumentare dhe deklarime dëshmitarësh që konfirmonin pronësinë e babait të kërkuarit mbi tokën. Pas padisë së kërkuarit kundër RTSH-së dhe operatorëve privatë për largimin e antenave të vendosura në pronë, Avokatura e Shtetit kërkoi rishikimin e vendimit të vitit 2006. Në vitin 2010, Agjencia e Rikthimit dhe Kompensimit të Pronave e anuloi vendimin, duke pretenduar mangësi në dokumentacion, probleme me hartat dhe mungesë provash të mjaftueshme mbi pronësinë e babait të kërkuarit. Gjykata e Apelit Tiranë vendosi në favor të kërkuarit, duke vlerësuar se kompetenca e Agjencisë për të rishikuar me iniciativë të vet vendime të formës së prerë ishte shpallur antikushtetuese nga Gjykata Kushtetuese. Megjithatë, në vitin 2016, Gjykata e Lartë prishi vendimin e apelit dhe la në fuqi anulimin e vendimit të vitit 2006, duke arsyetuar se kërkuari nuk kishte provuar pronësinë dhe se vendimi i Komisionit nuk ishte bërë asnjëherë i formës së prerë, pasi ishte kundërshtuar nga Avokatura e Shtetit. GJEDNJ konstatoi se vendimi i vitit 2006 kishte marrë formë të prerë, pasi afati i ankimit kishte kaluar pa u ushtruar mjete të zakonshme juridike dhe vetë Avokatura e Shtetit kishte përdorur një mekanizëm të jashtëzakonshëm rishikimi. Gjykata vlerësoi se kompetenca e pakufizuar në kohë e Avokaturës së Shtetit për të kundërshtuar vendime të formës së prerë cenonte sigurinë juridike dhe parashikueshmërinë procedurale. Gjykata theksoi se autoritetet vendase nuk identifikuan ndonjë defekt themelor procedural, mashtrim apo interes publik detyrues që të justifikonte prishjen e vendimit të formës së prerë. Në thelb, gjykatat vendase thjesht rivlerësuan të njëjtat prova dhe arritën në një përfundim tjetër mbi pronësinë, duke realizuar një rishqyrtim të maskuar të çështjes në kundërshtim me parimin e *res judicata* dhe sigurisë juridike.

Për vitin 2023



23. Hysa kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 52048/16, vendim i datës 21 shkurt 2023

Masë e sigurimit personal: proporcionaliteti, individualizimi i arsyetimit, rrethana personale

Maksima: 1. *Vijimësia e një dyshimi të arsyeshëm nuk mjafton, në vetvete, për të justifikuar paraburgimin; gjykatat duhet të japin arsye konkrete, të individualizuara dhe të mjaftueshme mbi nevojën reale të privimit nga liria. Arsyetimet abstrakte mbi rëndësinë e akuzës, dëmin ekonomik ose “rrezikshmërinë shoqërore” nuk përmbushin standardin e nenit 5 § 3 në mungesë të analizës së rrethanave personale të të pandehurit.* 2. *Gjykatat kanë detyrimin të shqyrtojnë realisht përshtatshmërinë e masave alternative ndaj paraburgimit dhe të arsyetojnë pse ato konsiderohen të pamjaftueshme.* 3. *Përfundimi i paraburgimit nuk e zhduk interesin legjitim të individit për kontroll kushtetues të ligjshmërisë së privimit të mëparshëm nga liria.* 4. *Refuzimi i gjykatave më të larta për të korrigjuar mangësitë në arsyetimin e paraburgimit përbën element relevant në konstatimin e shkeljes së nenit 5 § 3 të Konventës.*

Fjalë kyçe: neni 5 § 3 i Konventës, paraburgim, arrest me burg, arsyetim i pamjaftueshëm, dyshim i arsyeshëm, rreziku i arratisjes, rreziku i përsëritjes së veprës, masa alternative, proporcionalitet, rrethana personale, vendim de plano, kontroll kushtetues, interes legjitim, kontroll post factum, individualizimi i arsyetimit

Hysa v. Albania, application no. 52048/16, judgment of 21 February 2023

Personal security measure: proportionality, individualized reasoning and personal circumstances

Legal principle(s): 1. The continued existence of a reasonable suspicion is not, in itself, sufficient to justify pre-trial detention. The courts must provide concrete, individualized and sufficient reasons demonstrating the genuine necessity of the deprivation of liberty. Abstract references to the seriousness of the charges, the economic damage caused or the accused's "social dangerousness" do not satisfy the requirements of Article 5 § 3 of the Convention in the absence of an assessment of the accused's personal circumstances. 2. The courts are required to genuinely examine the suitability of alternatives to pre-trial detention and to explain why such measures are considered insufficient. 3. The termination of pre-trial detention does not extinguish the individual's legitimate interest in obtaining constitutional review of the lawfulness of the previous deprivation of liberty. 4. The failure of the higher courts to remedy deficiencies in the reasoning supporting pre-trial detention constitutes a relevant factor in finding a violation of Article 5 § 3 of the Convention.

Keywords: Article 5 § 3 of the Convention, pre-trial detention, detention on remand, insufficient reasoning, reasonable suspicion, risk of absconding, risk of reoffending, alternative measures, proportionality; personal circumstances, de plano decision, constitutional review, legitimate interest, post factum review, individualized reasoning

Përmbledhje: Çështja ka të bëjë me mungesën e arsyeve të mjaftueshme për paraburgimin e kërkueses, ish-drejtoreshë në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë, e dyshuar për shpërdorim detyre lidhur me rimbursime të TVSH-së në vlerë rreth 3.7 milionë euro. Më 5 nëntor 2013, Gjykata e Rrethit Tiranë urdhëroi paraburgimin e saj, duke iu referuar rëndësisë së veprës, dëmit ekonomik dhe "rrezikut të arratisjes", pa shpjeguar konkretisht pse kërkuesja paraqiste një rrezik të tillë. Kërkuesja argumentoi se ishte vetëdorëzuar vullnetarisht, ishte pezulluar nga detyra, nuk kishte mundësi të ndikonte mbi provat, kishte lidhje të qëndrueshme familjare dhe profesionale dhe se masa e arrestit me burg ishte disproporcionale. Më 27 nëntor 2013, Gjykata e Apelit Tiranë la në fuqi paraburgimin, duke u mbështetur kryesisht në rëndësinë e akuzës dhe

“rrezikshmërinë shoqërore” të veprës, si edhe në rrezikun se kërkuesja mund të kryente përsëri vepra penale, pa analizuar rrethanat konkrete personale të saj. Më 19 dhjetor 2013, Gjykata e Lartë e shpalli rekursin të papranueshëm me vendim *de plano*, duke mos shqyrtuar pretendimet e kërkueses mbi mungesën e arsytimit të paraburgimit. Më 24 shkurt 2016, Gjykata Kushtetuese refuzoi të shqyrtonte ankimin kushtetues me arsytimin se kërkuesja nuk kishte më interes juridik, pasi paraburgimi ishte zëvendësuar ndërkohë me arrest shtëpie. GJEDNJ konstatoi se gjykatat vendase kishin përdorur arsytime të përgjithshme dhe abstrakte, nuk kishin identifikuar fakte konkrete që provonin rrezikun e arratisjes ose përsëritjes së veprës penale, nuk kishin analizuar rrethanat personale të kërkueses dhe nuk kishin dhënë arsye reale pse masat alternative ndaj paraburgimit konsideroheshin të papërshtatshme. Gjykata vuri në dukje se rëndësia e akuzës dhe pasojat financiare të veprës nuk mjaftojnë, në vetvete, për të justifikuar paraburgimin dhe se pezullimi i kërkueses nga detyra kërkonte një analizë konkrete mbi pretendimin se ajo mund të kryente përsëri vepra penale. Gjithashtu, GJEDNJ kritikoi veçanërisht Gjykatën Kushtetuese, pasi refuzoi kontrollin kushtetues vetëm sepse masa e paraburgimit kishte përfunduar megjithëse kërkuesja kishte ende interes legjitim për një verifikim *post factum* të ligjshmërisë së privimit të saj nga liria dhe për një kërkesë eventuale për kompensim. Si rezultat, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 5 § 3 të Konventës.



24. Supergrav Albania SH.P.K kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 20702/18, vendim i datës 9 maj 2023

Aksesi në gjykatë: zbatimi formalist i afateve procedurale

Maksima: 1. Afati për paraqitjen e një ankimi nuk mund të fillojë përpara momentit kur pala ka dijeni efektive për ekzistencën dhe arsytimin e vendimit që synon të kundërshtojë. Zbatimi formalist i afateve procedurale cenon të drejtën e aksesit në gjykatë kur pala nuk ka pasur mundësi reale të njihet me përmbajtjen e vendimit gjyqësor. 2. Mungesa e njoftimit personal dhe vonesa në vënien në dispozicion të vendimit të arsyetuar nuk mund të rëndojnë mbi palën në përllogaritjen e afateve procedurale.

Fjalë kyçe: neni 6 § 1 KEDNJ, afat procedural, afati katërmujor, ankim kushtetues, dijeni efektive, njoftim i vendimit, vendim i arsyetuar, akses në gjykatë, Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë

Supergrav Albania SH.P.K. v. Albania, application no. 20702/18, judgment of 9 May 2023

Access to court: formalistic application of procedural time limits

Legal principle(s): 1. The time limit for lodging an appeal cannot begin to run before the party has gained effective knowledge of both the existence and the reasoning of the decision it seeks to challenge. A formalistic application of procedural time limits violates the right of access to a court where the party has not had a genuine opportunity to become acquainted with the content of the judicial decision. 2. The absence of personal notification and delays in making the reasoned decision available cannot be held against the party when calculating the applicable procedural time limits.


Keywords: Article 6 § 1 of the ECHR, procedural time limit, four-month time limit, constitutional appeal, effective knowledge, notification of a judicial decision, reasoned decision, access to a court, Constitutional Court, Supreme Court

Përmbledhje: Çështja ka të bëjë me cenimin e së drejtës së aksesit në Gjykatën Kushtetuese për shkak të mënyrës së përlllogaritjes së afatit katërmujor për paraqitjen e ankimit kushtetues. Shoqëria kërkuese kishte ngritur padi civile për dëmshpërblim ndaj policisë së Matit lidhur me çmontimin e makinerive të saj. Pas rrëzimit të padisë nga gjykatat e zakonshme, ajo paraqiti rekurs në Gjykatën e Lartë. Më 28 janar 2016, Gjykata e Lartë e rrëzoi rekursin me vendim të marrë pa praninë e palëve dhe pa arsyetim të plotë, duke shpallur vetëm dispozitivin. Në atë periudhë palët nuk njoftoheshin personalisht për seancat në Gjykatën e Lartë, ndaj nuk ekzistonte një mekanizëm efektiv për dorëzimin e vendimeve të arsyetuara dhe nuk provohej që vendimi i plotë të ishte publikuar ndonjëherë në faqen e internetit të gjykatës. Në vitin 2017, ligji uli afatin për ankim kushtetues nga dy vite në katër muaj. Shoqëria kërkuese kërkoi me shkrim kopjen e vendimit të Gjykatës së Lartë dhe e mori atë më 26 shtator 2017. Më 4 tetor 2017 paraqiti ankim kushtetues. Më 8 nëntor 2017, Gjykata Kushtetuese e shpalli ankimin të papranueshëm si jashtë afatit, duke e llogaritur afatin katërmujor nga data e marrjes së vendimit të Gjykatës së Lartë (28 janar 2016) dhe jo nga data kur vendimi i arsyetuar

iu vu realisht në dispozicion kërkueses.

GJEDNJ konstatoi se kërkuesja nuk kishte pasur mundësi reale të njëjhej me ekzistencën dhe arsyetimin e vendimit përpara datës 26 shtator 2017, afati procedural nuk mund të fillojë përpara se pala të ketë dijeni efektive për vendimin dhe arsyetimin e tij dhe interpretimi i Gjykatës Kushtetuese krijoi një barrierë procedurale disproporcionale që e privoi kërkuesen nga aksesit efektiv në gjykatë.

Gjykata theksoi se, në praktikën shqiptare të kohës Gjykata e Lartë shpallte fillimisht vetëm dispozitivin ndërsa arsyetimi i plotë publikohej ose vihej në dispozicion pas një kohe të konsiderueshme çka krijonte rrezikun që afati kushtetues të përfundonte përpara se pala të kishte akses në arsyetimin e vendimit. Përgjegjësia kryesore në këtë çështje iu atribuua Gjykatës Kushtetuese, pasi ajo e interpretoi afatin procedural në mënyrë tepër formaliste dhe e llogariti atë nga data e miratimit të vendimit të Gjykatës së Lartë, megjithëse kërkuesja nuk kishte dijeni reale për përmbajtjen e tij. GJEDNJ gjithashtu evidentoi edhe problematikat strukturore në praktikën e Gjykatës së Lartë lidhur me mungesën e njoftimit personal, mungesën e dorëzimit të vendimeve të arsyetuara dhe publikimin e vonuar të arsyetimit të plotë. Si rezultat, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për cenim të së drejtës së aksesit në gjykatë.



**25. Lazaris kundër Shqipërisë,
kërkesa nr. 48806/06,
vendim i datës 20 qershor 2023**

Parimi i barazisë së armëve: detyrimi për verifikimin e njoftimit të palëve në mënyrë konkrete

Maksima: 1. E drejta për një proces të rregullt ligjor kërkon që palëve t'u garantohet mundësi reale dhe efektive për të marrë pjesë në seancat gjyqësore dhe për të paraqitur argumentet e tyre në kushte barazie me palën kundërshtare. 2. Zhvillimi i një seance dëgjimore në mungesë të palës, pa njoftim personal dhe pa verifikim efektiv të dijenisë së saj mbi seancën, cenon parimin e barazisë së armëve dhe nenin 6 § 1 të Konventës. 3. Publikimi i njoftimit të seancës vetëm në ambientet e gjykatës ose në faqen e internetit nuk përbën garanci të mjaftueshme procedurale kur autoritetet kanë mundësi reale për të njoftuar drejtpërdrejt palën ose

përfaqësuesin e saj. 4. Gjykatat kanë detyrimin të verifikojnë në mënyrë konkrete nëse palët janë njoftuar realisht për seancën dhe të japin arsye mbi zhvillimin e procedurës në mungesë të tyre. 5. Mungesa e arsyetimit nga gjykatat kombëtare mbi çështjen e njoftimit procedural nuk mund të korrigjohet ex post facto në procedurat para GJEDNJ-së.

Fjalë kyçe: neni 6 § 1 KEDNJ, proces i rregullt ligjor, barazia e armëve, seancë in absentia, njoftim personal, akses në gjykatë, pjesëmarrja në seancë, njoftim procedural, mungesë arsyetimi

Lazaris v. Albania, application no. 48806/06, judgment of 20 June 2023

Principle of equality of arms: obligation to verify that the parties have been effectively notified

Legal principle(s): 1. The right to a fair trial requires that the parties be afforded a genuine and effective opportunity to participate in court hearings and to present their arguments under conditions that do not place them at a substantial disadvantage vis-à-vis the opposing party. 2. Holding a hearing in the absence of a party, without personal notification and without effectively verifying whether that party was aware of the hearing, violates the principle of equality of arms and Article 6 § 1 of the Convention. 3. Publishing notice of a hearing solely on the court premises or on its website does not constitute a sufficient procedural safeguard where the authorities have a genuine possibility of notifying the party or its representative directly. 4. The courts are required to verify specifically whether the parties have been notified of the hearing and to provide reasons for proceeding in their absence. 5. A failure by the domestic courts to provide reasons concerning procedural notification cannot be remedied retrospectively in the proceedings before the ECtHR.

Keywords: Article 6 § 1 of the ECHR, fair trial, equality of arms, hearing in absentia, personal notification, access to a court, participation in a court hearing, procedural notification, failure to provide reasons

Përmbledhja: Çështja ka të bëjë me zhvillimin e një seance gjyqësore në Gjykatën e Lartë në mungesë të kërkuarve dhe pa njoftim personal për ta ose për përfaqësuesit e tyre, në një proces civil mbi pronësinë e një trualli në Vlorë. Babai i kërkuarve kishte qenë pronar i një trualli prej 2,660 m² dhe i një banese, të shtetëzuara gjatë regjimit komunist.

Në vitin 1995, Komisioni për Rikthimin dhe Kompensimin e Pronave njohu të drejtën e kërkuësve mbi pronën dhe urdhëroi kthimin e një pjese të saj, ndërsa pjesa tjetër, e zënë nga një fabrikë vaji e privatizuar, do të kompensohej. Kërkuësit ngritën padi civile për anulimin e kontratës së privatizimit dhe rikthimin e truallit. Gjykata e Rrethit Vlorë dhe Gjykata e Apelit Vlorë vendosën në favor të tyre. Më pas, pala kundërshtare paraqiti rekurs në Gjykatën e Lartë. Më 7 korrik 2005, Gjykata e Lartë zhvilloi seancën gjyqësore pa praninë e kërkuësve apo të përfaqësuesve të tyre dhe pa u dërguar atyre njoftim personal. Në seancë morën pjesë dhe paraqitën argumente vetëm pala kundërshtare dhe përfaqësuesi i Agjencisë Kombëtare të Privatizimit. Gjykata e Lartë prishi vendimet e gjykatave më të ulëta dhe rrëzoi pretendimet e kërkuësve, pa adresuar çështjen e mungesës së tyre në seancë. Qeveria argumentoi se njoftimi për seancën ishte publikuar në ambientet e Gjykatës së Lartë dhe në faqen e saj të internetit, në përputhje me nenin 482 të Kodit të Procedurës Civile të kohës, i cili nuk parashikonte njoftim personal për palët.

GJEDNJ konstatoi se seanca në Gjykatën e Lartë kishte qenë dëgjimore dhe pala kundërshtare kishte paraqitur argumente verbale, kërkuësve nuk u ishte garantuar mundësia reale për të marrë pjesë dhe për të paraqitur argumentet e tyre. Gjykata e Lartë nuk kishte verifikuar nëse kërkuësit ishin njoftuar realisht dhe as Gjykata e Lartë, as Gjykata Kushtetuese nuk kishin dhënë arsye mbi mungesën e njoftimit ose mbi nevojën për zhvillimin e seancës në mungesë të tyre. Gjykata vlerësoi gjithashtu se autoritetet kishin mundësi reale për të njoftuar avokatin e kërkuësve, pasi identiteti dhe përfaqësimi i tij njiheshin nga dosja dhe ai ishte njoftuar rregullisht në fazat e mëparshme të procesit. Për këto arsye, GJEDNJ konstatoi se Gjykata e Lartë i kishte privuar kërkuësit nga mundësia për të paraqitur efektivisht çështjen e tyre dhe për të gëzuar barazinë e armëve me palën kundërshtare, në shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.



**26. Zeqo dhe Seat SH.P.K kundër
Shqipërisë, kërkesat nr. 61445/12
dhe 53157/15, vendim i datës
22 qershor 2023**

**Mosveprimi procedural i Gjykatës së Lartë për periudha të gjata
në çështje jo komplekse**

Maksima: 1. Mosveprimi procedural i Gjykatës së Lartë për periudha të gjata në çështje jo komplekse cenon të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm sipas nenit 6 § 1 të Konventës. 2. Arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave vlerësohet duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e palëve dhe autoriteteve, si dhe rëndësinë e çështjes për kërkuesin.

Fjalë kyçe: mosveprim procedural, çështje jo komplekse, e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, neni 6 § 1 KEDNJ, sjellja e palëve rëndësia e çështjes për kërkuesin.

Zego and Seat SH.P.K. v. Albania, applications nos. 61445/12 and 53157/15, judgment of 22 June 2023

Prolonged procedural inactivity by the Supreme Court in non-complex cases

Legal principle(s): 1. Prolonged procedural inactivity by the Supreme Court in cases of no particular complexity infringe the right to a hearing within a reasonable time under Article 6 § 1 of the Convention. 2. The reasonableness of the length of proceedings must be assessed in the light of the complexity of the case, the conduct of the parties and the relevant authorities, and the importance of what is at stake for the applicant.

Keywords: procedural inactivity, non-complex cases, right to a hearing within a reasonable time, Article 6 § 1 of the ECHR, conduct of the parties, conduct of the authorities, importance of the case for the applicant

Përmbledhje: Çështja ka të bëjë me tejzgjatjen e procedurave civile në dy procese të ndryshme gjyqësore në Shqipëri. Në kërkesën e parë, kërkuesi u ankua vetëm për kohëzgjatjen e procedurës në Gjykatën e Lartë, në një mosmarrëveshje kontraktore ndërmjet palëve private. Procesi para Gjykatës së Lartë zgjati rreth dy vite e gjysmë dhe përfundoi me rrëzimin *de plano* të rekursit. GJEDNJ konstatoi se çështja nuk paraqiste kompleksitet të veçantë juridik dhe se Gjykata e Lartë nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim procedural gjatë gjithë periudhës së shqyrtimit.

Në kërkesën e dytë, shoqëria kërkuese u ankua për një proces civil mbi detyrime kontraktore që kishte zgjatur mbi nëntë vite në katër nivele juridiksioni. GJEDNJ vuri në dukje se gjykatës së shkallës së parë iu deshën më shumë se tre vite për të dhënë vendim, pas kthimit për rigjykim kishte pasur periudha të gjata mosveprimi procedural dhe nuk kishte indicie që kërkuesja të kishte kontribuar në zgjatjen e procesit.

GJEDNJ konstatoi se në të dyja çështjet procedurat kishin tejkaluar standardin e “afatit të arsyeshëm” sipas nenit 6 § 1 të Konventës. Ajo theksoi

se çështjet nuk kishin kompleksitet të tillë që të justifikonte kohëzgjatjen, autoritetet kombëtare kishin treguar periudha të gjata pasiviteti procedural dhe Qeveria nuk kishte paraqitur shpjegime bindëse për vonesat.



**27. Prima SH.P.K. dhe Kozmai kundër
Shqipërisë, kërkesa nr. 33183/07,
vendim i datës 19 shtator 2023**

Standardet e arsytimit të vendimit

Maksima: 1. Detyrimi i gjykatave për të arsyetuar vendimet nuk kërkon domosdoshmërisht përgjigje të shprehur për çdo argument procedural, kur ai argument nuk është vendimtar për rezultatin e çështjes. 2. Mosshqyrtimi i një argumenti procedural nuk cenon nenin 6 § 1 të Konventës kur rezultati i çështjes mbështetet në baza të tjera të mjaftueshme dhe të pavarura juridike. 3. Shfuqizimi i një leje ndërtimi nuk cenon të drejtën e pronësisë kur leja ka humbur vlefshmërinë, nuk është rinovuar nga mbajtësi i saj dhe ndërtimi bie ndesh me legjislacionin urbanistik.

Fjalë kyçe: neni 6 § 1 KEDNJ, neni 1 i Protokollit nr. 1 KEDNJ, arsyetimi i vendimit, argument vendimtar, leje ndërtimi, shfuqizim leje

Prima SH.P.K. and Kozmai v. Albania, application no. 33183/07, judgment of 19 September 2023

Standards governing the reasoning of judicial decisions

Legal principle(s): 1. The obligation of the courts to provide reasons for their decisions does not necessarily require an express response to every procedural argument where that argument is not decisive for the outcome of the case. 2. The failure to address a procedural argument does not violate Article 6 § 1 of the Convention where the outcome of the case is based on other sufficient and independent legal grounds. 3. The revocation of a building permit does not violate the right to property where the permit has expired, has not been renewed by its holder and the construction is contrary to urban-planning legislation.

Keywords: Article 6 § 1 of the ECHR, Article 1 of Protocol No. 1 ECHR, reasoning of judicial decisions, decisive argument, building permit, revocation of a permit

Përmbledhje: Çështja ka të bëjë me pretendimin e kërkuësve se Gjykata e Lartë nuk kishte arsyetuar mosshqyrtimin e kundërshtimit të tyre mbi parashkrimin e padisë civile të fqinjëve kundër lejes së ndërtimit dhe se shfuqizimi i lejes kishte cenuar të drejtën e tyre të pronësisë. Shoqëria kërkuese kishte marrë në vitin 1997 leje planifikimi dhe ndërtimi për një truall në pronësi të kërkuësit të dytë. Pas fillimit të punimeve, fqinjët ngritën padi civile për pezullimin e ndërtimit dhe shfuqizimin e lejes së ndërtimit. Pas disa fazave gjyqësore Gjykata e Apelit rrëzoi padinë, duke arsyetuar se kërkesa për shfuqizimin e lejes ishte paraqitur jashtë afatit 30-ditor procedural por Gjykata e Lartë e prishi këtë vendim dhe shfuqizoi lejet e planifikimit dhe ndërtimit, duke konstatuar se ndërtimi cenonte të drejtat e fqinjëve dhe ishte në kundërshtim me legjislacionin urbanistik. Gjykata e Lartë theksoi gjithashtu se leja e ndërtimit ishte dhënë vetëm për gjashtë muaj dhe kërkuësit nuk kishin kërkuar rinovimin ose zgjatjen e saj, për rrjedhojë, leja kishte humbur vlefshmërinë e saj pavarësisht debatit procedural mbi afatin e padisë së fqinjëve.

GJEDNJ konstatoi se edhe pse Gjykata e Lartë nuk e trajtoi shprehimisht çështjen e parashkrimit, kjo nuk kishte ndikim vendimtar në rezultat sepse leja e ndërtimit kishte skaduar objektivisht dhe nuk ishte rinovuar ndërsa Gjykata e Lartë kishte trajtuar në mënyrë të mjaftueshme çështjet thelbësore të ligjshmërisë së ndërtimit dhe mbrojtjes së pronës së fqinjëve. Gjykata vlerësoi gjithashtu se shfuqizimi i lejes së ndërtimit nuk ishte arbitrar por kërkuësit kishin treguar mungesë vigjilence duke mos kërkuar rinovimin e saj dhe ndërhyrja në interesat e tyre pasurore ishte e justifikuar nga nevoja për respektimin e legjislacionit urbanistik dhe mbrojtjen e të drejtave të fqinjëve. Për rrjedhojë, GJEDNJ e shpalli kërkesën haptazi të pabazuar dhe të papranueshme si në aspektin e nenit 6 § 1, ashtu edhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1.



**28. Nuraj kundër Shqipërisë,
kërkesa nr. 35703/17,
vendim i datës 10 tetor 2023**

Kufizim imuniteti shtetëror në mosmarrëveshje pune

Maksima: 1. Imuniteti juridiksional i një shteti të huaj në mosmarrëveshjet e punësimit nuk mund të zbatohet automatikisht vetëm për

shkak se punëmarrësi është i punësuar pranë një ambasade. 2. Kufizimi i së drejtës për akses në gjykatë është proporcional vetëm kur gjykatat analizojnë konkretisht nëse detyrat e punëmarrësit lidhen realisht me ushtrimin e autoritetit sovran të shtetit të huaj. Funksionet administrative, sekretariale ose përkthimi i materialeve jo konfidenciale nuk përbëjnë ushtrim të autoritetit qeveritar në kuptim të nenit 11 § 2 të Konventës së KB 2004. Një akses i përgjithshëm ose i papërcaktuar në materiale sensitive nuk mjafton, në vetvete, për të justifikuar imunitetin shtetëror në një mosmarrëveshje pune.

Fjalë kyçe: imunitet i një shteti të huaj, zbatim automatik, akses në gjykatë, neni 6 § 1 KEDNJ, mosmarrëveshje pune, ambasadë e huaj, Konventa e Vjenës, Konventa e KB 2004, funksione administrative, përkthim dokumentesh, proporcionalitet

Nuraj v. Albania, application no. 35703/17, judgment of 10 October 2023

Limitations on State immunity in employment disputes

Legal principle(s): 1. The jurisdictional immunity of a foreign State in employment disputes cannot be applied automatically merely because the employee works at an embassy. 2. A restriction on the right to access a court is proportionate only where the courts specifically have to assess whether the employee's duties are genuinely connected with the exercise of the foreign State's sovereign authority. 3. Administrative or secretarial duties, or the translation of non-confidential materials, do not constitute the exercise of governmental authority within the meaning of Article 11 § 2 of the 2004 United Nations Convention on Jurisdictional Immunities of States and Their Property. 4. General or undefined access to sensitive materials is not sufficient to justify State immunity in an employment dispute.

Keywords: immunity of a foreign State, automatic application, access to a court, Article 6 § 1 of the ECHR, employment dispute, foreign embassy, Vienna Convention, 2004 United Nations Convention, administrative functions, translation of documents, proportionality

Përmbledhje: Çështja ka të bëjë me refuzimin e gjykatave shqiptare për të shqyrtuar padinë e kërkuësës për pushim të padrejtë nga puna kundër Ambasadës së Katarit në Tiranë, për shkak të imunitetit shtetëror. Kërkuësja kishte punuar pranë ambasadës si sekretare dhe oficerë

administrative, ndërsa në praktikë kryente edhe përkthime të materialeve të shtypit shqiptar. Pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës në vitin 2014, ajo ngriti padi civile për largim të paligjshëm nga puna. Gjykata e Rrethit Tiranë rrëzoi pretendimin për imunitet shtetëror dhe pranoi juridiksionin, duke vlerësuar se mosmarrëveshja kishte natyrë private (*“iure gestionis”*) dhe jo ushtrim të sovranitetit shtetëror (*“iure imperii”*). Megjithatë, Gjykata e Lartë e shpalli rekursin të papranueshëm për shkak të imunitetit shtetëror, duke u mbështetur në Konventën e Vjenës dhe në faktin se pala e paditur nuk kishte hequr dorë nga imuniteti diplomatik. Pas ankimit kushtetues, Gjykata Kushtetuese e prishi këtë vendim dhe e riktheu çështjen për rigjykim, duke kërkuar që Gjykata e Lartë të analizonte praktikën e GJEDNJ-së mbi kufizimin e imunitetit shtetëror në mosmarrëveshjet e punësimit, të shqyrtonte natyrën konkrete të detyrave të kërkuases, dhe të vlerësonte nëse zbatohet ndonjë nga përjashtimet e nenit 11 § 2 të Konventës së KB 2004 mbi Imunitetet Juridiksionale të Shteteve.

Në rigjykim, Gjykata e Lartë pranoi ekzistencën e praktikës së GJEDNJ-së për kufizimin e imunitetit shtetëror në çështjet e punësimit, por sërish e shpalli rekursin të papranueshëm. Ajo arriti në përfundimin se aktiviteti i kërkuases lidhej drejtpërdrejt me funksionet diplomatike të shtetit të Katarit, ajo kishte akses në materiale konfidenciale dhe detyrat e saj nuk kishin natyrë thjesht administrative. Gjykata Kushtetuese më pas e shpalli të papranueshëm ankimin kushtetues të kërkuases.

GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për cenim të së drejtës së aksesit në gjykatë. Gjykata vlerësoi se detyrat e kërkuases si sekretare dhe përkthyes nuk përbënin ushtrim të autoritetit qeveritar, nuk ishte provuar që ajo të kishte ushtruar funksione sovrane të shtetit të huaj dhe gjykatat shqiptare nuk kishin analizuar konkretisht natyrën reale të detyrave të saj, por ishin mbështetur kryesisht në faktin formal se ajo punonte në një ambasadë. Gjykata theksoi gjithashtu se përkthimi i artikujve të shtypit nuk mund të konsiderohej aktivitete konfidencial që lidhej me ushtrimin e autoritetit shtetëror dhe një akses i kufizuar në materiale sensitive nuk mjaftonte për të justifikuar imunitetin juridiksional të shtetit të huaj.



**29. Durdaj dhe të tjerë kundër Shqipërisë,
kërkesa nr. 63543/09,
vendim i datës 7 nëntor 2023**

Pjesëmarrja efektive në procesin penal e viktimave dhe familjarëve të tyre

Maksima: 1. Neni 2 i Konventës kërkon jo vetëm që shteti të përmbahet nga privimi arbitrar i jetës, por edhe të krijojë dhe zbatojë një kuadër efektiv rregullator për aktivitetet e rrezikshme që mund të cenojnë jetën e individëve. 2. Hetimi procedural sipas nenit 2 duhet të jetë i pavarur, efektiv, i shpejtë dhe i aftë të identifikojë dhe ndëshkojë përgjegjësit për humbjen e jetës. 3. Viktimave dhe familjarëve të tyre duhet t'u garantohet pjesëmarrje efektive në procedimin penal në masën e nevojshme për mbrojtjen e interesave të tyre legjitimë. 4. Zvarritja e procedimeve penale për periudha tepër të gjata, veçanërisht në çështje që lidhen me humbjen e jetës dhe përgjegjësinë shtetërore, cenon detyrimin procedural të nenit 2 të Konventës.

Fjalë kyçe: neni 2 KEDNJ, përgjegjësi shtetërore, e drejta për jetën, aspekti procedural i nenit 2, aspekti material i nenit 2, hetim efektiv, pjesëmarrje efektive e viktimave, zvarritje e procedimeve, palë civile në proces penal

***Durdaj and Others v. Albania, application no. 63543/09,
judgment of 7 November 2023***


***Effective participation of victims and their families in
criminal proceedings***

Legal principle(s): 1. Article 2 of the Convention requires the State not only to refrain from the arbitrary deprivation of life, but also to establish and implement an effective regulatory framework governing dangerous activities that may endanger individuals' lives. 2. An investigation conducted under the procedural limb of Article 2 must be independent, effective, prompt and capable of identifying and punishing those responsible for the loss of life. 3. Victims and their families must be afforded effective participation in the criminal proceedings to the extent necessary to safeguard their legitimate interests. 4. Excessive delays in criminal proceedings, particularly in cases concerning loss of life and State responsibility, violate the procedural obligation arising under Article 2 of the Convention.

Keywords: *Article 2 of the ECHR, State responsibility; right to life, procedural limb of Article 2, substantive limb of Article 2, effective investigation, effective participation of victims; excessive length of proceedings, civil party to criminal proceedings*

Përmbledhje: Çështja ka të bëjë me shpërthimin katastrofik të ndodhur më 15 mars 2008 në objektin e çmontimit të armëve në Gërdec, i cili shkaktoi vdekjen e 26 personave, plagosjen e rreth 300 të tjerëve dhe dëme materiale masive. Kërkesit ishin familjarë të viktimave dhe persona të plagosur nga shpërthimi. Objekti i Gërdecit ishte ngritur për çmontimin dhe çmilitarizimin e municioneve të vjetruara të forcave të armatosura shqiptare. Aktiviteti zhvillohej në bazë të një serie vendimesh dhe urdhrash të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Këshillit të Ministrave, në bashkëpunim me kompaninë shtetërore MEICO, kompaninë amerikane SAC dhe nënkontraktorin shqiptar Albademil SH.P.K. Nga hetimet rezultoi se objekti funksiononte në kushte të rënda pasigurie, mungonin licencat përkatëse, nuk kishte standarde të sigurisë teknike, punëtorët ishin të patrajnuar, përdorej fuqi punëtore familjare, përfshirë fëmijë, mungonin sistemet kundër zjarrit dhe masat antistatike dhe sasi të mëdha eksplozivësh ruheshin në mënyrë të pasigurt pranë zonave të banuara. Raporti i ekspertëve amerikanë të ATF-IRT arriti në përfundimin se procedurat e përdorura në Gërdec nuk ishin në përputhje me standardet normale të sigurisë për trajtimin e eksplozivëve dhe se objekti nuk duhej të ishte ngritur pranë rrugëve publike dhe banesave. Hetimi penal filloi menjëherë pas shpërthimit dhe përfshiu zyrtarë të lartë shtetërorë, drejtues të MEICO-s, administratorë të kompanive private dhe ish-ministrin e Mbrojtjes. Prokuroria evidentoi një seri veprimesh dhe mosveprimesh në kundërshtim me ligjin, përfshirë autorizimin e një objekti të palicencuar, mungesën e mbikëqyrjes së sigurisë, transferimin e municioneve në kundërshtim me rregullat ushtarake dhe lejimin e operacioneve të rrezikshme pa infrastrukturën e nevojshme. Kërkesit pretenduan përpara GJEDNJ se shteti kishte dështuar të mbronte jetën e viktimave, hetimi penal nuk kishte qenë efektiv, procedimet ishin zvarritur për vite të tëra dhe viktimat nuk kishin mundur të merrnin pjesë realisht në procesin penal. Një element qendror i çështjes ishte fakti se Gjykata e Lartë kishte veçuar padinë civile të viktimave nga procedimi penal, duke ua hequr atyre mundësinë për të marrë pjesë si palë civile në gjykimin penal. Kërkesit argumentuan se kjo i kishte privuar nga e drejta për të kërkuar prova, për të pyetur dëshmitarët dhe për të ndikuar në zhvillimin e procedimit penal. GJEDNJ bëri dallim midis aspektit material dhe procedural të nenit 2 të

Konventës. Për aspektin material, Gjykata konstatoi se disa prej kërkuesve kishin humbur statusin e viktimës pasi autoritetet shqiptare kishin njohur përgjegjësinë shtetërore në procese administrative dhe kishin dhënë dëmshpërblim. Për kërkuesit e tjerë, Gjykata konstatoi mosshërim të mjeteve juridike të brendshme, pasi ata nuk kishin ngritur padi civile kundër shtetit për dëmshpërblim. Megjithatë, për aspektin procedural të nenit 2, Gjykata konstatoi shkelje të Konventës. Ajo vlerësoi se ndonëse hetimi fillestar kishte qenë i gjerë dhe kishte identifikuar përgjegjësit kryesorë procedimi penal ndaj ish-ministrit të Mbrojtjes ishte zvarritur për më shumë se katërmëdhjetë vjet. Autoritetet kishin treguar inertësi dhe mungesë efikasiteti dhe kërkuesve nuk u ishte garantuar pjesëmarrje efektive në procedim. Gjykata vlerësoi se një procedim penal për ngjarje me pasoja kaq të rënda duhet të zhvillohej me shpejtësi, efektivitet dhe transparencë të veçantë, sidomos kur përfshiheshin pretendime për përgjegjësi të nivelit të lartë shtetëror.



**30. Prifti kundër Shqipërisë,
kërkesa nr. 56288/12,
vendim i datës 21 nëntor 2023**

Pretendim për jurisprudence kontradiktore të Gjykatës së Lartë-ekzistenca “e dallimeve të thella dhe afatgjata”

Maksima: 1. *Mundësia e vendimeve të ndryshme gjyqësore është pjesë e natyrshme e çdo sistemi gjyqësor dhe nuk cenon Konventën për sa kohë nuk provohet ekzistenca e një jurisprudence kontradiktore të konsoliduar. Gjykata Evropiane nuk ndërhyr ndaj dallimeve sporadike në interpretimin gjyqësor kur ato lidhen me vlerësimin konkret të fakteve dhe jo me një konflikt të qëndrueshëm jurisprudencial. 2. Arsyeimi i mjaftueshëm i Gjykatës së Lartë mbi përgjegjësinë individuale përjashton pretendimin për arbitraritet gjyqësor.*

Fjalë kyçe: jurisprudence kontradiktore, dallime sporadike, vlerësim faktesh, qëndrueshmëri jurisprudenciale, neni 6 § 1 KEDNJ, përgjegjësi individuale, arbitraritet

Prifti v. Albania, application no. 56288/12, judgment of 21 November 2023

Alleged inconsistency in the Supreme Court's case-law: existence of "profound and long-standing differences"

Legal principle(s): 1. The possibility of differing judicial decisions is an inherent feature of any judicial system and does not, in itself, violate the Convention unless the existence of established and persistent conflicting case-law is demonstrated. The European Court does not intervene in respect of isolated differences in judicial interpretation where they arise from the assessment of the particular facts of a case rather than from a consistent conflict in the case-law. 2. Sufficient reasoning by the Supreme Court concerning individual responsibility rules out an allegation of judicial arbitrariness.

Keywords: conflicting case-law, isolated differences, assessment of facts; consistency of case-law, Article 6 § 1 of the ECHR, individual responsibility, judicial arbitrariness

Përmbledhje: Çështja ka të bëjë me pretendimin për praktikë kontradiktore të Gjykatës së Lartë në çështje të ngjashme disiplinore në shërbimin civil. Kërkuesi, ish-përgjegjës i sektorit të auditit në Drejtorinë e Tatimeve Fier, u shkarkua nga detyra në vitin 2006 për shkelje të rënda disiplinore dhe dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit, bazuar në një raport të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Dy vartës të tij, të shkarkuar mbi bazën e të njëjtit raport, fituan proceset gjyqësore kundër largimit nga puna. Në rastin e kërkuarit Komisioni i Shërbimit Civil dhe Gjykata e Apelit kishin shfuqizuar shkarkimin, duke konstatuar mosrespektim të procedurave disiplinore dhe mungesë të provimit të përgjegjësisë individuale por Gjykata e Lartë, me vendim të datës 24 maj 2011, prishi këto vendime dhe la në fuqi shkarkimin nga detyra. Në vendim Gjykata e Lartë arsyetoi se procedurat disiplinore ishin respektuar, raporti i auditit përmbante fakte të mjaftueshme për përgjegjësinë e kërkuarit dhe shkeljet e konstatuara përbënin shkelje të rënda disiplinore sipas legjislacionit për shërbimin civil.

Kërkuesi pretendoi përpara GJEDNJ se Gjykata e Lartë kishte dhënë vendime kontradiktore në raste identike, pasi në çështjen e vartësit të tij A.Q. kishte arritur në përfundim të kundërt mbi të njëjtin raport auditimi. GJEDNJ konstatoi se megjithëse kishte dallime në rezultatet e çështjeve, kërkuesi nuk provoi ekzistencën e “dallimeve të thella dhe afatgjata” në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë. Në rastet konkrete bëhej fjalë për

vlërësime individuale të fakteve dhe jo për një konflikt të konsoliduar jurisprudencial dhe në çdo rast Gjykata e Lartë kishte dhënë arsyetim të mjaftueshëm për përgjegjësinë individuale të kërkesit. Për rrjedhojë, GJEDNJ e shpalli kërkesën haptazi të pabazuar dhe të papranueshme.



**31. Gurma kundër Shqipërisë,
kërkesa nr. 50249/13,
vendim i datës 28 nëntor 2023**

Afati i arsyeshëm: kompleksitet i çështjes

Maksima: 1. Efektet e një vendimi gjyqësor janë të kufizuara *ratione personae* dhe nuk mund të cenojnë të drejtën e një pale të tretë për të kundërshtuar pronësinë në një procedim të veçantë. 2. Rrëzimi *de plano* i rekursit nga Gjykata e Lartë mund të përmbushë kërkesat e nenit 6 § 1 kur gjykatat më të ulëta kanë dhënë arsyetim të plotë dhe rekursi nuk ngre çështje ligjore relevante. 3. Kohëzgjatja e procedurave duhet të vlerësohet në raport me kompleksitetin e çështjes, numrin e instancave dhe sjelljen e autoriteteve gjyqësore.

Fjalë kyçe: *res judicata*, siguri juridike, konflikt pronësie, tituj të mbi-vendosur, palë e tretë, *ratione personae*, neni 6 § 1 KEDNJ, Neni 1 i Protokollit nr. 1 KEDNJ, Gjykata e Lartë, rekurs *de plano*, arsyetim vendimi, tejzgjatja e procedurave, afati i arsyeshëm

Gurma v. Albania, application no. 50249/13, judgment of 28 November 2023

Reasonable time requirement: complex case

Legal principle(s): 1. The effects of a judicial decision are limited *ratione personae* and cannot prejudice the right of a third party to contest ownership in separate proceedings. 2. The *de plano* dismissal of an appeal on points of law by the Supreme Court may satisfy the requirements of Article 6 § 1 of the Convention where the lower courts have provided full reasoning and the appeal raises no relevant legal issues. 3. The length of proceedings must be assessed in the light of the complexity of the case, the number of levels of jurisdiction involved and the conduct of the judicial authorities.

Keywords: *res judicata*, legal certainty, property dispute, over-

lapping property titles, third party; ratione personae, Article 6 § 1 of the ECHR, Article 1 of Protocol No. 1 ECHR, Supreme Court, de plano dismissal of an appeal on points of law, reasoning of judicial decisions, excessive length of proceedings, reasonable time

Përmbledhje: Çështja ka të bëjë me një konflikt pronësie mbi një parcelë prej 910 m² në Sarandë, ku kërkuesi pretendonte se prona i ishte kthyer me vendim të Komisionit të Kthimit të Pronave dhe me një vendim gjyqësor të vitit 2003, ndërsa pala tjetër (A.C.) kishte fituar titull pronësie mbi të njëjtën parcelë që prej vitit 1996 nëpërmjet blerjes nga Bashkia Sarandë. Kërkuesi ngriti padi për njohjen dhe dorëzimin e posedimit të parcelës, ndërsa A.C. kundërshtoi vlefshmërinë e vendimeve të kthimit të pronës. Pas bashkimit të procedimeve, Gjykata e Apelit Gjyrokastër rrëzoi pretendimet e kërkuesit dhe pranoi kundërpadinë e A.C., duke arsyetuar se vendimet e kthimit të pronës ishin bazuar në dokumentacion të paplotë dhe të pasaktë, nuk provohej shtetëzimi i pronës, parcela e kthyer mbivendosej me parcelën e A.C. dhe vendimi i vitit 2003 nuk mund të prodhonte efekte ndaj A.C., pasi ajo nuk kishte qenë palë në atë procedim. Gjykata e Lartë rrëzoi rekursin *de plano*, ndërsa Gjykata Kushtetuese refuzoi ankimin kushtetues.

Në lidhje me pretendimet e kërkuesit GJEDNJ konstatoi se procedurat e mëvonshme nuk përbënin rishqyrtim të një çështjeje ndërmjet të njëjtave palë, pasi A.C. nuk kishte qenë palë në procedimin e vitit 2003. Parimi i *res judicata* ka kufizime *ratione personae* dhe nuk pengon një person të tretë të mbrojtë të drejtat e tij pronësore në procese të ndara. Për sa kohë Gjykata e Apelit kishte dhënë arsyetim të detajuar mbi konfliktin e titujve të pronësisë arsyetimi i kufizuar i Gjykatës së Lartë në rrëzimin *de plano* të rekursit ishte i mjaftueshëm në kuptim të nenit 6 § 1. Lidhur me kohëzgjatjen e procedurave, Gjykata vlerësoi se çështja ishte komplekse, pasi përfshinte procedime të shumta, kundërpadi dhe konflikt titujsh pronësorë, procedurat kishin zgjatur rreth tetë vite e dhjetë muaj në katër nivele juridiksioni dhe gjashtë instanca, por asnjëra prej gjykatave nuk kishte qëndruar pasive për periudha të pajustificuara. Për rrjedhojë, GJEDNJ e shpalli kërkesën haptazi të pabazuar dhe të papranueshme.



**32. Osmani kundër Shqipërisë,
kërkesa nr. 8706/18,
vendim i datës 5 dhjetor 2023**

Shpronësim *de facto*-kompensim i plotë dhe i përshtatshëm për pronën

Maksima: 1. *E drejta për një vendim të arsyetuar cenohet kur gjykatat miratojnë një vlerësim kompensimi për shpronësim pa shpjeguar arsyet e refuzimit të provave dhe vlerësimeve alternative të paraqitura në proces. 2. Në rastet e shpronësimit *de facto*, individi ka pritshmëri legjitime për të marrë kompensim të plotë dhe të përshtatshëm për pronën e marrë nga autoritetet publike.*

Fjalë kyçe: *e drejta për vendim të arsyetuar, kompensim për shpronësim, shpronësim *de facto*, neni 6 § 1 KEDNJ, neni 1 i Protokollit nr. 1 KEDNJ, e drejta e pronës, pritshmëri legjitime.*

Osmani v. Albania, application no. 8706/18, judgment of 5 December 2023

De facto expropriation: complete and adequate compensation for property

Legal principle(s): *1. The right to a reasoned decision is violated where the courts endorse an assessment of compensation for expropriation without explaining why the evidence and alternative valuations submitted in the proceedings were rejected. 2. In cases of *de facto* expropriation, the individual has a legitimate expectation of receiving full and adequate compensation for the property taken by the public authorities.*

Keywords: *right to a reasoned decision, compensation for expropriation, *de facto* expropriation, Article 6 § 1 of the ECHR, Article 1 of Protocol No. 1 to the ECHR, right to property, legitimate expectation*

Përmbledhje: Çështja ka të bëjë me kompensimin për shpronësimin *de facto* të një pjese të pronës së kërkuarit për ndërtimin e një rruge publike në Vorë. Në vitin 2010, autoritetet nisën punimet dhe prishën një pjesë të objekteve dhe rrethimit të pronës së kërkuarit, ndërkohë që procedura

formale e shpronësimit nuk kishte përfunduar ende. Gjatë procesit gjyqësor, u paraqitën disa vlerësime të ndryshme mbi vlerën e truallit të marrë nga shteti: ekspertja e caktuar nga gjykata vlerësoi çmimin e tregut në rreth 160 euro/m² dhe sipas VKM-së referuese në rreth 86 euro/m², ndërsa autoritetet shtetërore propozuan kompensim rreth 20–22 euro/m². Gjykata e Rrethit dhe Gjykata Administrative e Apelit miratuan vlerësimin më të ulët të paraqitur nga autoritetet, pa dhënë arsytim mbi refuzimin e vlerësimeve të tjera dhe pa analizuar kriteret e përdorura për përcaktimin e kompensimit. Në rekurs, kërkuesi u ankua se gjykatat nuk kishin arsyetuar shumën e kompensimit dhe kishin cenuar të drejtën e tij të pronës. Megjithatë, Gjykata e Lartë e rrëzoi rekursin si të papranueshëm pa adresuar çështjen e metodës së përlllogaritjes së kompensimit. Edhe Gjykata Kushtetuese nuk trajtoi këtë pretendim në thelb. GJEDNJ konstatoi se çështja kryesore në proces ishte përcaktimi i një kompensimi të përshtatshëm për pronën e marrë nga shteti dhe se gjykatat shqiptare nuk kishin dhënë arsye relevante dhe të mjaftueshme për pranimin e vlerësimit më të ulët dhe rrëzimin e alternativave të tjera të paraqitura në proces. Gjykata theksoi gjithashtu se prona ishte marrë përpara përfundimit të procedurës formale të shpronësimit, duke krijuar një situatë shpronësimi *de facto*, ku kërkuesi kishte pritshmëri legjitime për kompensim të plotë. Për këto arsye, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 për mungesë arsyetimi lidhur me shumën e kompensimit dhe për mosgarantimin e një kompensimi të përshtatshëm për pronën e marrë nga autoritetet.

Për vitin 2022



33. Laçej dhe të tjerë kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 22122/08, vendim i datës 29 shtator 2022

Afat i arsyeshëm: kompleksitet i çështjes

Maksima – 1. Kohëzgjatja e procedurave civile nuk përputhet me standardin e “afatit të arsyeshëm” kur çështja mbetet për vite të tëra pa veprime procedurale efektive nga gjykata kompetente. Mungesa e kompleksitetit të çështjes dhe mungesa e kontributit të palëve në vonesë janë elemente relevante për konstatimin e shkeljes së nenit 6 § 1. 2. Vetëm palët në procedurat kombëtare mund të pretendojnë statusin e “viktimës” për shkak të tejzgjatjes së procedurave sipas nenit 34 të Konventës.

Fjalë kyçe – tejzgjatja e procedurave, afati i arsyeshëm, neni 6 § 1 KEDNJ, Gjykata e Lartë, pasivitet procedural

***Laçej and Others v. Albania, application no. 22122/08,
judgment of 29 September 2022***

Reasonable-time requirement: complexity of the case

Legal principle(s): 1. The length of civil proceedings is incompatible with the “reasonable time” requirement where a case remains pending for several years without effective procedural action by the competent court. The absence of complexity and the fact that the parties did not contribute to the delay are relevant factors in finding a violation of Article 6 § 1 of the Convention. 2. Only parties to the domestic proceedings may claim “victim” status in respect of their excessive length under Article 34 of the Convention.

Keywords: *excessive length of proceedings, reasonable time; Article 6 § 1 of the ECHR, Supreme Court, procedural inactivity, victim status, Article 34 of the ECHR*

Përmbledhje - Çështja lidhej me tejzgjatjen e procedurave civile, veçanërisht përpara Gjykatës së Lartë. Kërkuesit H. L. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë dhe Komuniteti Musliman i Shqipërisë kishin marrë pjesë në procedurat civile në nivel kombëtar, përfshirë procedurat përpara Gjykatës së Lartë. Rekursi i tyre u regjistrua në Gjykatën e Lartë më 26 janar 2010. GJEDNJ konstatoi se pas regjistrimit të rekursit, Gjykata e Lartë qëndroi pasive për pothuajse katër vite dhe vetëm në vitin 2014 u zhvilluan katër seanca dëgjimore. Autoritetet shqiptare nuk dhanë asnjë shpjegim bindës që të justifikonte këtë kohëzgjatje. Gjykata vlerësoi se çështja nuk paraqiste elemente të tillë kompleksiteti që të justifikonin vonesën dhe kohëzgjatja e procedurave nuk përputhej me kërkesën e “afatit të arsyeshëm” sipas nenit 6 § 1 të Konventës. Si rezultat, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për tejzgjatje të procedurave civile.

Dy kërkues të tjerë, S. LL. dhe A. U. u shpallën të papranueshëm *ratione personae*, pasi nuk kishin qenë palë në procedurat kombëtare dhe nuk mund të pretendonin statusin e “viktims” sipas Konventës.

Për vitin 2021



**34. Bara dhe Kola kundër Shqipërisë,
kërkesat nr. 43391/18 dhe 17766/19,
vendim i datës 12 tetor 2021**

Afat i arsyeshëm: pasivitet procedural i Gjykatës së Lartë

Maksima: 1. Shteti mbetet përgjegjës për organizimin e sistemit gjyqësor në mënyrë që gjykatat të garantojnë gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, edhe në kontekstin e reformave strukturore në drejtësi. 2. Pasiviteti procedural për disa vite në Gjykatën e Lartë, pa veprime efektive për shqyrtimin e rekursit, cenon kërkesën e “afatit të arsyeshëm” sipas nenit 6 § 1 të Konventës. 3. Një mjet juridik për tejzgjatjen e procedurave është efektiv vetëm nëse ofron në praktikë mundësi reale për përshpejtimin e procedurës ose kompensim adekuat për vonesën. 4. Pushimi i kërkesës për përshpejtim vetëm sepse gjykata ndërmerr një hap procedural minimal nuk përbën domosdoshmërisht zgjidhje efektive sipas nenit 13 të Konventës.

Fjalë kyçe – tejzgjatja e procedurave, afati i arsyeshëm, neni 6 § 1 KEDNJ, neni 13 KEDNJ, Gjykata e Lartë, reforma në drejtësi, stok gjyqësor.

Bara and Kola v. Albania, application nos. 43391/18 and 17766/19, judgment of 12 October 2021

Reasonable-time requirement: procedural inactivity by the Supreme Court

Legal principle(s): 1. The State remains responsible for organising its judicial system in a manner that enables the courts to guarantee the determination of cases within a reasonable time, including in the context of structural judicial reforms. 2. Procedural

inactivity lasting several years before the Supreme Court, without effective steps being taken to examine an appeal on points of law, violates the “reasonable time” requirement under Article 6 § 1 of the Convention. 3. A remedy in respect of the excessive length of proceedings is effective only where, in practice, it provides a genuine possibility of accelerating the proceedings or obtaining adequate compensation for the delay. 4. Discontinuing proceedings concerning a request for acceleration solely because the court has taken a minimal procedural step does not necessarily constitute an effective remedy within the meaning of Article 13 of the Convention.

Keywords: *excessive length of proceedings, reasonable time, Article 6 § 1 of the ECHR, Article 13 of the ECHR, Supreme Court, judicial reform, backlog*

Përmbledhje: Çështja ka të bëjë me tejzgjatjen e procedurave administrative dhe penale, veçanërisht me vonesat e gjata në Gjykatën e Lartë, si edhe me efektivitetin e mjetit të ri juridik të parashikuar nga nenet 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile për kohëzgjatjen e procedurave. Në çështjen Bara, kërkuesi kundërshtoi në gjykatë rezultatin e zgjedhjeve për rektor të Universitetit të Mjekësisë Tiranë. Pas përfundimit relativisht të shpejtë të procedurave administrative dhe në dy shkallët e para, rekursi i tij mbeti pezull në Gjykatën e Lartë nga tetori 2016 deri në shkurt 2021, pa asnjë veprim procedural. GJEDNJ vuri në dukje se çështja nuk ishte komplekse, kërkuesi kishte kërkuar vazhdimisht përsheptimin e procedurës dhe mosmarrëveshja kishte rëndësi të veçantë kohore, pasi mandati i rektorit ishte katërvjeçar.

Në çështjen Kola, kërkuesi ishte dënuar me burgim të përjetshëm për vrasje. Pas kthimit të çështjes për rigjykim nga Gjykata e Lartë në vitin 2016, ai paraqiti rekurs të ri në mars 2017. Në kohën e shqyrtimit nga GJEDNJ, Gjykata e Lartë kishte pranuar rekursin për shqyrtim, por ende nuk kishte caktuar datë për shqyrtimin në themel. GJEDNJ pranoi se reforma e thellë në drejtësi dhe procesi i vetting-ut kishin krijuar vështirësi reale për funksionimin e Gjykatës së Lartë, duke sjellë mungesë kuorumi dhe rritje drastike të backlog-ut. Megjithatë, Gjykata theksoi se këto rrethana nuk mund të justifikonin në mënyrë të pakufizuar pasivitetin procedural, backlog-u ekzistonte edhe përpara reformës dhe shteti mbetet përgjegjës për organizimin e sistemit gjyqësor në mënyrë që të respektohet kërkesa e “afatit të arsyeshëm”. Sa i përket mjetit të ri juridik sipas neneve 399/1 e vijues të KPC-së, GJEDNJ vlerësoi se ai ishte efektiv në parim dhe përgjithësisht në praktikë por nuk ishte efektiv në rrethanat konkrete

të kërkuësve, pasi kërkesat e tyre ose mbetën pa rezultat praktik, ose u pushuan pasi Gjykata e Lartë ndërmori veprime minimale procedurale. GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për tejzgjatje të procedurave, si edhe shkelje të nenit 13 në lidhje me nenin 6 § 1 për mungesë të një mjeti juridik efektiv në rrethanat konkrete të çështjeve.



35. Laçi kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 28142/17, vendim i datës 19 tetor 2021

Akresi në gjykatë: proporcionaliteti - vlerësim real i individualizuar i gjendjes financiare

Maksima: 1. Kufizimet financiare për aksesin në drejtësi duhet t'i nënshtrohen një kontrolli rigoroz proporcionaliteti, veçanërisht kur nuk lidhen me meritat e padisë dhe kur pala ndodhet në pamundësi reale ekonomike. 2. Pasiviteti procedural dhe vonesat në shqyrtimin e çështjeve të ndërmjetme që kushtëzojnë aksesin në gjykatë mund ta bëjnë të drejtën për gjykim teorike dhe iluzore.

Fjalë kyçe: kufizime financiare për aksesin në drejtësi, kontroll proporcionaliteti, pamundësi ekonomike, vonesa, kërtime të ndërmjetme, akses në gjykatë, e drejtë iluzore, neni 6 § 1 KEDNJ.

Laçi v. Albania, application no. 28142/17, judgment of 19 October 2021

Access to court: proportionality and an effective, individualized assessment of financial circumstances

Legal principle(s): 1. Financial restrictions on access to justice must be subject to a rigorous proportionality assessment, particularly where they are unrelated to the merits of the claim and the party is genuinely unable to bear the relevant costs. 2. Procedural inactivity and delays in examining interim applications that determine access to a court may render the right to judicial proceedings theoretical and illusory.

Keywords: financial restrictions on access to justice, proportionality assessment, financial inability, delays, interim applications, access to a court, illusory right, Article 6 § 1 of the ECHR

Përmbledhje: Çështja ka të bëjë me pamundësinë e kërkuarit për të siguruar shqyrtimin në themel të padisë së tij për dëmshpërblim lidhur me shpërthimin e Gërdecit, për shkak të mosvlerësimit efektiv të kërkesës së tij për përjashtim nga taksa gjyqësore. Kërkuari, i papunë dhe me pension shumë të ulët, kërkoi përjashtim nga pagesa e një takse padie prej rreth 960,000 ALL, por Komisioni Shtetëror për Ndihmë Juridike nuk i dha përgjigje kërkesës; Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ia ktheu padinë për mospagim të taksës, megjithëse pranoi gjendjen e tij të vështirë ekonomike ndërsa procedimi mbi këtë çështje mbeti pezull për vite në Gjykatën e Lartë. GJEDNJ konstatoi se gjykatat vendase nuk kryen një vlerësim real dhe të individualizuar të gjendjes financiare të kërkuarit ndërkohë, tarifa gjyqësore ishte disproporcionale në raport me të ardhurat e tij. Vonesat procedurale, veçanërisht në Gjykatën e Lartë, e bënë aksesin e tij në gjykatë praktikisht iluzor. Në këto kushte GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për cenim të së drejtës për akses në gjykatë.

Për vitin 2020



36. Strazimiri kundër Shqipërisë, kërkesa nr. 34602/16, vendim i datës 21 janar 2020

Trajtim çnjerëzor dhe poshtërues: mungesa e institucioneve të specializuara për trajtimin e personave me çrregullime mendore (pacientë forensikë)

Maksima: 1. Mbajtja e një personi me çrregullime mendore në institucione penitenciare, në mungesë të trajtimit terapeutik të specializuar dhe të kushteve të përshtatshme mjekësore, mund të përbëjë trajtim çnjerëzor dhe poshtërues sipas nenit 3 të Konventës. 2. Privimi nga liria i një personi me çrregullime mendore nuk është “i ligjshëm” sipas nenit 5 § 1 (e) kur shteti dështon të sigurojë vendosjen e tij në institucionin e specializuar të parashikuar nga ligji i brendshëm. 3. Mungesa strukturore e institucioneve të specializuara për trajtimin e personave me çrregullime mendore nuk e përjashton shtetin nga përgjegjësia sipas Konventës. 4. Vonesat e konsiderueshme në shqyrtimin gjyqësor të ligjshmërisë së ndalimit cenojnë garancitë e nenit 5 § 4 të Konventës.

Fjalë kyçe: Neni 3 KEDNJ, trajtim çnjerëzor dhe poshtërues, shëndet mendor, trajtim i detyruar mjekësor, institucion i specializuar, mungesa strukturore, vonesa gjyqësore, ligjshmëri e ndalimit

Strazimiri v. Albania, application no. 34602/16, judgment of 21 January 2020

Inhuman and degrading treatment: lack of specialised institutions for individuals with mental health disabilities (forensic patients)

Legal principle(s): 1. Detaining a person with mental disorders in a penitentiary institution, in the absence of specialised therapeutic treatment and appropriate medical conditions, may amount to inhuman and degrading treatment within the meaning of Article 3 of the Convention. 2. The deprivation of liberty of a person with mental disorders is not “lawful” under Article 5 § 1 (e) of the Convention where the State fails to ensure that the person is placed in the specialised institution prescribed by domestic law. 3. The structural lack of specialised institutions for the treatment of persons with mental disorders does not exempt the State from its responsibility under the Convention. 4. Significant delays in the judicial review of the lawfulness of detention violate the guarantees of Article 5 § 4 of the Convention.

Keywords: Article 3 of the ECHR, inhuman and degrading treatment, mental health, compulsory medical treatment, specialised institution, structural deficiencies, judicial delays, lawfulness of detention, Article 5 § 1 (e) of the ECHR, Article 5 § 4 of the ECHR

Përmbledhje: Çështja ka të bëjë me mbajtjen për një periudhë shumëvjeçare të kërkuesit, i diagnostikuar me skizofreni paranojake dhe i përjashtuar nga përgjegjësia penale, në institucione penitenciare dhe jo në një institucion të specializuar mjekësor, siç kërkonte legjislacioni shqiptar. Pas një tentative vrasjeje në vitin 2008, gjykatat shqiptare urdhëruan trajtimin e detyruar mjekësor të kërkuesit me shtrim spitalor, duke e konsideruar si person me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Megjithatë, ai u mbajt për vite me radhë në Burgun e Krujës dhe më pas në Qendrën Spitalore të Burgut, për shkak të mungesës së një institucioni të posaçëm psikiatrik në sistemin shëndetësor.

GJEDNJ konstatoi se kushtet materiale të ndalimit dhe mungesa e trajtimit terapeutik të përshtatshëm përbënin trajtim çnjerëzor dhe poshtërues në kundërshtim me nenin 3. Kërkuesi morri kryesisht trajtim farmakologjik, pa rehabilitim psikosocial apo psikoterapi të specializuar ndërkohë që autoritetet shqiptare kishin krijuar një situatë të “braktisjes terapeutike”. Gjykata vlerësoi gjithashtu se mbajtja e kërkuesit në institucione pe-

nitenciare nuk ishte “e ligjshme” sipas nenit 5 § 1 (e), pasi ligji shqiptar kërkonte trajtim në një institucion të specializuar mjekësor. Mungesa për vite me radhë e një institucioni të tillë përbënte problem strukturor dhe autoritetet kishin dështuar të zbatonin kuadrin ligjor vendas. Lidhur me nenin 5 § 4, GJEDNJ konstatoi se procedurat e ankimit mbi ligjshmërinë e ndalimit zgjatën rreth tre vite përpara Gjykatës së Lartë dhe kjo vonesë iu atribuua plotësisht autoriteteve shtetërore. Gjykata konstatoi gjithashtu shkelje të nenit 5 § 5, pasi kërkuesi nuk dispononte një të drejtë efektive dhe të zbatueshme për kompensim lidhur me shkeljet e konstatuara sipas nenit 5 § 1 dhe 4.

Ky botim u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Përmbytja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian



Bashkëfinancuar dhe zbatuar
nga Këshilli i Evropës

